



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme /Ministarstvo Unutrašnjih Poslova /Ministry Of Internal Affairs

**STRATEGJIA SHITETËRORE PËR RIINTEGRIM TË QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË
RIATDHESUAR NË KOSOVË**

2018-2022



Prishtinë, 2017

Lista e shkurtesave	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
HYRJE	6
METODOLOGJIA.....	7
Parimet	7
SFONDI	8
Ripranimi.....	9
RIINTEGRIMI I PERSONAVE TË RIATDHESUAR	10
FAKTORËT QË NDIKOJNË NË RIINTEGRIM TË QËNDRUESHËM	11
Korniza politike dhe qasja strategjike	11
Financimi.....	12
Decentralizimi dhe roli i organeve komunale	12
Sistemi për Menaxhimin e Rasteve (SMR).....	12
Asistenca Ndërkombëtare.....	12
Sigurimi i efektshmërisë.....	12
Harmonizimi i qasjes institucionale ndaj zhvillimit socio-ekonomik	13
Shkëmbimi i informatave me shtetet kthyes.....	13
Mbështetja e grupeve specifike	14
Bashkërendimi i Partnerëve zbatues	14
Vetëdijësimi i Publikut.....	14
Financimi.....	14
Faktorët përtej fushëveprimit të ndikimit të Qeverisë së Kosovës	15
VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT	16
Vizioni	16
Misioni	16
Objektivat Strategjike dhe specifike.....	16
Alternativat e shqyrtuara	18
ZBATIMI	Error! Bookmark not defined.
GRUPET E CENUESHME.....	22
MEKANIZMAT ZBATUES	25
AKTIVITETET DHE NISMAT	27
Pasqyra e kufizimeve.....	28
Plani i Veprimit	29
MONITORIMI DHE VLERËSIMI.....	30
Identifikimi i indikatorëve.....	31
Menaxhimi i rrezikut	31
Komunikimi	31
Buxheti	31
SHTOJCAT	32

LISTA E SHKURTESAVE

ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
BE	Bashkimi Evropian
DPPA	Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme
DRPR	Departamenti për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KA	Komisioni për Ankesa
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KKR	Komisioni Komunal për Riintegrim
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MeD	Ministria e Diasporës
MF	Ministria e Financave
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara për Administratë në Kosovë
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
SMR	Sistemi për Menaxhimin e Rasteve
QAP	Qendrat e Aftësimit Profesional
ZKKK	Zyrat për Komunitete dhe Kthim
QPS	Qendrat për Pune Sociale
ZP	Zyrat e Punësimit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e migrimit dhe riintegrimin të personave të riatdhesuar, paraqesin aspekt të rëndësishëm në marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me shtetet anëtare të BE-së¹ në kuadër të angazhimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Qeveria) për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Strategjia Nacionale për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar, në tekstin e mëtejme referohet si Strategjia për Riintegrim, përshkruan politikat dhe masat që duhen ndërmarrë për sigurimin e riintegrimin të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar. Gjithashtu, ky dokument ofron kornizën institucionale për menaxhimin e riintegrimin të personave të riatdhesuar, definon rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe lokale në secilën fazë të procesit të riintegrimin në tërësi, si dhe përcakton procedurat dhe mekanizmat e bashkërendimit për të trajtuar nevojat dhe për të promovuar të drejtat e personave të riatdhesuar.

Kjo strategji ka definuar pesë objektiva strategjike për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar gjatë periudhën kohore 2018-2022. Avancimi i masave për riintegrim të qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar duke aplikuar qasje gjithëpërfshirëse bazuar në nevoja dhe adresimi i nevojave të veçanta të grupeve të cënueshme përbejnë thelbin e kësaj strategjie. Avancimi i bashkëpunimit rajonal, ndërkombëtar dhe ndërinstitucional si dhe zhvillimi i vazhdueshëm i ekspertizës vendore vazhdon të jetë prioriteti i institucioneve relevante të përfshira në riintegrim, në mënyrë që të avancohet më tutje ky proces. Kjo strategji përmban një objektiv të tërë strategjik që i kushtohet monitorimit sistematik dhe vlerësimit të ndikimit të masave të ndërmarra në qëndrueshmërinë e riintegrimin të personave të riatdhesuar.

Objektivi strategjik 1: Avancimi i sistemit të riintegrimin për personat e riatdhesuar duke aplikuar qasjen e orientuar në nevoja;

Objektivi strategjik 2: Riintegrimi i qëndrueshëm socio-ekonomik i personave të riatdhesuar;

Objektivi strategjik 3: Avancimi i bashkëpunimit gjithëpërfshirës në fushën e riintegrimin;

Objektivi strategjik 4: Fuqizimi i kapaciteteve për sigurimin e një qasje të integruar në sistemin e riintegrimin;

Objektivi strategjik 5: Fuqizimi i monitorimit dhe i vlerësimit të zbatimit të politikave të riintegrimin.

Për zbatim të suksesshëm të Strategjisë për Riintegrim është hartuar Plani i Veprimit, në të cilin pasqyrohen të gjitha masat konkrete të veprimit për të gjitha institucionet e ngarkuara me zbatimin e saj. Plani i Veprimit përmban objektivat e përgjithshme dhe specifike, aktivitetet konkrete për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv, saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, koston e përafërt financiare për zhvillimin e aktiviteteve dhe indikatorët matës të objektivave dhe aktiviteteve.

Në Kosovë është vendosur një sistem i qëndrueshëm i procesit të riintegrimin të personave të riatdhesuar, i rregulluar me kornizë ligjore, institucionale, politika adekuate dhe implementimi në praktikë. Ky sistem kërkon që të shtohet fokusi në nevoja specifike individuale të të riatdhesuarve. Kjo do të ndikojë pozitivisht në shkallën e kënaqshme të klientëve me shërbimet e ofruara dhe riintegrimin e tyre të qëndrueshëm. Prandaj, me qëllim të përmbushjes së nevojave specifike dhe avancimin e vazhdueshëm të shërbimeve gjatë viteve në vijim, planifikohet të të aplikohet qasja e bazuar dhe e përshtatur në nevoja individuale.

¹ Shtetet Anëtare të BE-së kanë qenë vend destinacion për shumicën e emigrantëve nga Republika e Kosovës

Riintegrimi i qëndrueshëm social dhe ekonomik i të riatdhesuarve do të vazhdojë të jetë në fokus të masave që do të ndërmerren në periudhën e ardhshme pesë vjeçare. Avancimi i sistemit për menaxhimin e rasteve, fuqizimi i masave që do të ndërmerren në nivel komunal, koordinimi ndërinstucional, vlerësimi i nevojave dhe aplikimi i qasjes bazuar në nevoja specifike për grupe të veçanta si dhe monitorimi e vlerësimi i procesit të riintegrit do të jenë shtyllat kryesore të kësaj strategjie.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet riintegrit dhe shërbimeve specifike për grupet e ndryshme të cënueshme duke zbatuar qasjen e bazuar në nevoja. Me implementim të kësaj strategjie synohet të avancohen shërbimet dhe të plotësohen nevojat e fëmijëve të riatdhesuar, fëmijëve të pashoqëruar, viktimave të trafikimit me njerëz, personave të kthyer nga zonat e konfliktit, individëve me varësi nga substancat suptrypike/narkotike, personave me të kaluar kriminale, personave në gjendje të rëndë shëndetësore si dhe personave me nevoja të veçanta psikologjike.

Institucionet e përfshira në riintegrim, në nivel komunal, duhet të fuqizohen në masë të madhe në mënyrë që të plotësojnë mandatin e tyre të përcaktuar me Rregulloren Nr.13/2017 për Reintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe dokumentet tjera të politikave të riintegrit në ofrimin e shërbimeve për personat e riatdhesuar dhe t'i kontribuojnë riintegrit të qëndrueshëm.

Të gjitha institucionet vendore të përfshira në procesin e riintegrit duhet të intensifikojnë bashkëpunimin në nivel horizontal dhe vertikal për të siguruar rrjedhë dhe kualitet të ofritit të asistencës së nevojshme dhe riintegrim të qëndrueshëm.

Bashkëpunimi me institucionet përkatëse, në nivel ndërkombëtar dhe rajonal, duhet të avancohet në përgjigje të fluksit të kthimit dhe nevojave të riintegrit. Gjatë periudhës së ardhshme do të vazhdojë bashkëpunimi me qëllim që të bëhet shkëmbimi i informatave me shtetet kthyesë dhe të maksimalizohet asistencën e ofruar nga institucionet ndërkombëtare dhe donatorët në Kosovë.

Menaxhimi i procesit të riintegrit është proces dinamik dhe kërkon zhvillim të vazhdueshëm të kapaciteteve njerëzore të personave të involvuar në këtë proces, prandaj edhe gjatë periudhës në vazhdim është e nevojshme të punohet në ngritje të kapacitete për të aplikuar qasjen e bazuar në nevoja, përfshirë standardet për trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve për grupet specifike të cënueshme si dhe monitorimin dhe vlerësimin e procesit të riintegrit.

Sfidat e identifikuar do të adresohen përmes **objektivave** konkrete, të cilat synohet të arrihen brenda një periudhe pesë vjeçare:

- Avancimi i sistemit të riintegrit për personat e riatdhesuar duke aplikuar qasjen e orientuar në nevoja;
- Avancimi dhe ndërmarrja e masave relevante socio-ekonomike për integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar;
- Avancimit i sistemit të riintegrit të grupeve të cënueshme duke aplikuar qasjen e orientuar në nevojat specifike për secilin grup;
- Zhvillimi i sistemit për riintegrim të suksesshëm të personave të riatdhesuar nga zonat e konfliktit;
- Avancimi i bashkëpunimit gjithëpërfshirës në fushën e riintegrit;
- Fuqizimi i kapaciteteve të stafit të përfshirë në proces të riintegrit;
- Avancimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të procesit të riintegrit.

HYRJE

Strategjia për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë është dokument udhëheqës që pasqyron dinamikën e riintegrit, boshllëqet dhe sfidat e identifikuara gjatë monitorimit të këtij procesi dhe masat që duhen ndërmarrë institucionet përkatëse, kriteret që dalin nga procesi i integritit evropian si dhe inkorporon praktikatat më të mira të procesit të riintegritit.

Në hartimin e Strategjisë për Riintegrim dhe Planit të Veprimit, janë konsultuar dokumentet e politikave qeveritare në fushën e migracionit, akterët relevantë dhe palët me interes.

Riintegrimi i qëndrueshëm është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë, dhe atë të MPB-së për vitin 2017 parashihet hartimi i Strategjisë për Riintegrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Kosovë. Qeveria ka paraparë procesin e riintegritit si fushë prioritare të veprimit në Deklaratën e Politikave Prioritare (2012-2020) dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2018-2020.²

Në kuadër të Agjendës Evropiane të Kosovës, kriteret nga Udhërrëfytyesi për Liberalizimin e Vizave të përcaktuara në Blllokun 0, Ripranimi dhe Riintegrimi tashmë janë përmbushur. Gjatë hartimit të Strategjisë për Riintegrim, janë adresuar të gjitha kërkesat që dalin nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Strategjia për Riintegrim do të zbatohet në periudhën pesë (5) vjeçare (2018-2022), ndërsa Plani i Veprimit përfshin aktivitete që do të zbatohen për periudhën tri (3) vjeçare (2018 - 2020), me mundësi rishikimi në baza vjetore.

² Riintegrimi i qëndrueshëm është vendosur nën objektivin e dytë të Deklaratës së Politikave Afatmesme, të quajtur "Avancimi i Procesit të integritit evropian dhe përforsimin e bashkëpunimit ndërkombëtar".

METODOLOGJIA

Strategjia është hartuar nga ekipi punues, i udhëhequr nga Ministria e Punëve të Brendshme, me pjesëmarrjen dhe kontributin e të gjitha institucioneve relevante qendrore e lokale të përfshira në procesin e riintegrit të personave të riatdhesuar. Qeveria falënderon shoqërinë civile për kontributin e dhënë në hartimin e kësaj Strategjie.

Gjatë hartimit të strategjisë janë konsultuar dokumentet ligjore dhe të politikave qeveritare në fushën e migrimit, ministrinë relevante, komunat dhe akterët tjerë vendor e ndërkombëtar. Gjithashtu, janë marrë parasysh përparësitë dhe dobësitë e procesit të riintegrit, rekomandimet nga Komisioni Evropian dhe partnerët tjerë ndërkombëtar dhe të gjeturat nga vlerësimi i strategjisë aktuale.

Qeveria e Republikës së Kosovë, e vlerëson kontributin e Komisionit Evropian, UNDP-së, IOM, UNICEF-it, OSBE-së, ICITAP-it, GIZ-it, BB-se dhe akterëve tjerë vendor e ndërkombëtar, dhe i falënderon për mbështetjen e ofruar në hartimin e kësaj Strategjie.

PARAMET

Strategjia e Riintegrit, ndër të tjera, është hartuar në bazë të parimeve si në vijim:

Qëndrueshmëria: Të gjitha objektivat e definuara dhe aktivitetet e planifikuara garantojnë riintegrim të qëndrueshëm dhe janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të planifikuara me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH);

Qeverisja e mirë : Llogaridhënia dhe transparenca janë parime që udhëheqin punën dhe veprimet e planifikuara me këtë dokument strategjik;

Sundimi i ligjit: Strategjia mbështetë sundimin e ligjit nga të gjithë akterët dhe kontribuon në zbatueshmërinë e legjislacionit që rregullon dhe ndërlidhet me procesin e riintegrit;

Subsidiariteti: Shërbimet e riintegrit që burojnë nga kjo strategji do të ofrohen në nivel lokal që të jenë sa më afër qytetarëve, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me rregulloret përkatëse dhe me mbështetjen e nivelit qendror.

Adresimi i sfidave: Kjo Strategji adreson sfidat e identifikuar gjatë zbatimit të strategjisë paraprake, boshllëqet dhe nevojat e identifikuar gjatë monitorimit dhe vlerësimit të ndikimit të politikave të riintegrit dhe konsultimeve me ministrinë relevante, komunat dhe akterët lokal e ndërkombëtar;

Harmonizimi i ndihmës: Strategjia e Riintegrit synon harmonizimin e asistencës të ofruar nga burimet shtetërore dhe donatorët ndërkombëtarë si dhe promovon ekspertizën e shoqërisë civile për të siguruar që praktikat më efikase të mundshme të zbatohen në përkrahje të riatdhesuarve;

Universaliteti dhe mosdiskriminimi: Të gjithë personat e riatdhesuar, pavarësisht nga mosha, gjinia, përkatësia etnike, feja dhe raca, përfshihen në procesin e riintegrit. Asistenca dhe mbështetja nga programi i riintegrit u ofrohet personave të riatdhesuar sipas kritereve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare;

Vëmendje e veçantë për nevojat e më të cenueshmit: Strategjia e Riintegrit i kushton vëmendje të posaçme nevojave të personave të riatdhesuar që i takojnë grupeve të cenueshme dhe parasheh mbështetje specifike të përshtatur sipas nevojave të tyre;

Fleksibiliteti për përfituesit : Standardizimi i hapave, aktiviteteve, procedurave dhe shërbimeve përcillet me një shkallë të lartë fleksibiliteti gjatë ofrimit të shërbimeve me qëllim të përmbushjes së nevojave specifike;

1. SFONDI

Popullsia kosovare, përgjatë historisë njihet si popullsi emigruese si pasojë e ndikimit të rrethanave dhe zhvillimeve të ndryshme politiko-ekonomike në të kaluarën. Për shkak se procesi i emigrimit është proces i vazhdueshëm, analizat kryesore në Kosovë janë bërë kryesisht për emigracionin e ri duke filluar nga vitet e 60-të apo siç quhet *Migracioni i ri*. Migracioni i ri, varësisht prej faktorëve të ndryshëm që kanë ndikuar në emigrim janë ndarë në tri faza kryesore të emigrimit: 1) Emigracioni politik i viteve 1969-1989; 2) Emigracioni politik-ekonomik 1990-1999 dhe 3) Emigracioni socio-ekonomik pas vitit 2001.

Emigracioni politik (1969-1989), përfshinte personat (familjet e tyre) që ishin të përndjekur për shkak të bindjeve politike, at ishin të diskriminuar, kishin të kufizuar lirinë e të shprehurit apo ishin kundër sistemit të pranishëm shtetëror në atë kohë. *Emigracioni politik-ekonomik* (1990-1999) është pasojë e masave politike që ishin ndërmarrë në Kosovë gjatë viteve 90-të, pas humbjes së vendeve të punës një pjesë e madhe e kosovarëve e cila u detyrua të emigrojë. Në fund të viteve 1998-1999, për shkak të luftës, mijëra kosovarë u larguan drejt vendeve të rajonit (Shqipëri dhe Maqedoni) dhe një pjesë e tyre emigroi kryesisht në vendet perëndimore. Numri më i madh i personave që kishin emigruar nga Kosova ishte gjatë viteve 90-të, kishte arritur kulmin gjatë luftës së viteve 1998-99. Kushtet socio-ekonomike ishin si faktorë shtytës determinues për *Emigracionin socio-ekonomik* (pas vitit 2001), një emigrim të shprehur si: sigurimi i një vendi të punës, sigurimi i një të ardhme më të mirë ekonomike apo standard më të lartë të jetesës. Një fluks migrimi u shënuar edhe në periudhën 2014/15, ku afërsisht 110,000 persona, vlerësohet se kanë kaluar ilegalisht kufijtë e BE-së. Këtu ka ndikuar ndër të tjera edhe fakti se Kosova ende mbetet i vetmi shtet i rajonit që mbetet i izoluar, pa të drejtë të lëvizjes së lirë pa viza.

Migrimi ndërkombëtar - sipas të dhënave të disponueshme vlerësohet se janë më shumë se 550.000 banorë kosovarë që kanë emigruar nga Kosova prej vitit 1969. Popullsia me prejardhje kosovare, përfshirë të lindurit jashtë Kosovës, është vlerësuar të jetë 703,978 banorë deri me 01 prill 2011³. Në vitin 2016 llogaritet se jetojnë jashtë vendit më shumë se 870 mijë persona me prejardhje kosovare apo mbi 49% e popullsisë rezidente në Kosovë⁴.

Migrimi neto- gjatë periudhës 2012-2016, vlerësohet se Kosova ka humbur 122,657 banorë apo rreth 6.9 % të popullsisë se Kosovës⁵. Numri i emigranteve kosovarë gjatë vitit 2016 ishte gjithsej 22,012 persona, apo 1.2% e popullsisë rezidente⁶. Në këtë numër janë përfshirë të gjithë emigrantët pa marrë parasysh arsyen e migrimit dhe statusin e tyre (legal dhe ilegal).

Kthimi (2012-2016) – kosovarëve që u i ishte refuzuar kërkesa për azil dhe ata që nuk kishin leje për qëndrim të përhershëm u prekën nga zbatimi i rregulloreve për riatdhesim. Kështu, gjatë viteve 2012-2016, një numër i konsiderueshëm i popullsisë janë kthyer në Kosovë me një mesatare vjetore prej 9,614 personave, apo 0, 53% e popullsisë brenda një viti⁷.

³ Agjencia e Statistikës së Kosovës: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/demografia-dhe-migracioni>


⁴ Ministria e Punëve të Brendshme, PROFILI i MIGRIMIT 2016

⁵ Po aty

⁶ Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2016, faqe 9 tabela 2: Prishtinë, qershor 2017: <http://ask.rks-gov.net/media/3385/vleresimi-i-popullise-se-kosoves-2016.pdf>

⁷ Po aty


Figura 1. Trendi i kthimit në Kosovë për vitet 2012-2016



Burimi:ASK

Emigrimi (2012-2016)- Të dhënat për periudhën 2012-2016 tregojnë se Kosova vazhdon të ketë shkallë të lartë të emigrimit me një mesatare prej 34,145, apo 1.91% emigrim brenda një viti⁸.

Figura 2. Emigrimi kosovar, i vlerësuar nga ASK, 2012-2016



Burimi:ASK

Ripranimi


Qeveria ka zhvilluar mekanizmat e domosdoshëm ligjorë dhe institucionalë për menaxhimin e procesit të ripranimit, derisa respektohet dinjiteti dhe të drejtat e qytetarëve të Kosovës. Karakteristikat dhe sfidat që ndërlidhen me veprimet e ripranimit në Kosovë kanë pasur ndikim të posaçëm në hartimin e kësaj strategjie. Ripranimi është mekanizëm i rëndësishëm i politikave për menaxhimin e migrimit të parregullt. Zbatimi i legjislacionit për ripranim ka përparësi sa i përket bashkëpunimit për ripranim me vendet me të cilat Kosova ende nuk ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe për ripranim, kurse me shtetet me të cilat Kosova ka marrëveshje bilaterale për ripranim, zbatohen marrëveshjet e ripranimit. Deri më tani, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar gjithsej 21 marrëveshje bilaterale të ripranimit⁹. Zbatimi i marrëveshjeve për ripranim është një faktor i rëndësishëm për parandalimin dhe luftimin e migrimit të parregullt.

⁸ Ministria e Punëve të Brendshme, PROFILI i MIGRIMIT 2016

⁹Marrëveshjet e nënshkruara: Shqipëri, Francë, Zvicër, Gjermani, Danimarkë, Norvegji, Austri, Slloveni, R. Çeke, Belgjikë, Luksemburgu, Holande, Mali i Zi, Suedi, Finlandë, Bullgari, Hungari, Maltë, Estoni, Lihtenshtajn, Kroaci Italia dhe Turqinë.

Të dhënat vjetore nga Policia e Kosovës dhe Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim tregojnë se numri i të ripranuarve (me forcë dhe vullnetarë) gjatë periudhës 2013-2016 ishte 41,481 persona. Nga ky numër, me forcë 54%, kurse vullnetarë 46%.

Figura 2: Kthimi i vullnetshëm dhe i detyruar 2013-2016



Burimi: PK dhe DSHAM

Trendët e ripranimit tregojnë se numri i personave të ripranuar është rritur në vitin 2015 dhe 2016 si pasojë e emigrimit të parregullt të kosovarëve në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015.

2. Riintegrimi i personave të riatdhesuar

Riintegrimi i personave të riatdhesuar është proces kompleks që kërkon bashkëpunim dhe bashkërendim të veprimeve të të gjitha institucioneve dhe organizatave të përfshira në këtë proces. Konteksti socio-ekonomik dhe politik në Kosovë gjithashtu përcakton si trendët e migrimit ashtu edhe ato të riintegrit. Harmonizimi i politikave dhe programeve për riintegrim dhe zbatimin adekuat i tyre janë parakusht për suksesin e procesit.

Riintegrimi i personave të riatdhesuar, konsiston në ripërfshirjen e personave të riatdhesuar në shoqërinë kosovare dhe përmirësimin e kushteve të tyre sociale dhe ekonomike. Riintegrimi i personave të riatdhesuar, paraqet një aspekt të rëndësishëm në përfshirjen sociale dhe ekonomike të qytetarëve të Kosovës. Si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjeve të ripranimit, dhe bazuar në nevojat e personave pas kthimit, u zhvilluan politikat e riintegrit, u themeluan strukturat përkatëse dhe çdo vit ndahet buxheti i nevojshëm për mbështetjen e procesit të riintegrit të personave të riatdhesuar.


Personat e riatdhesuarit paraqesin një kategori heterogjene nga aspekti i statusit të tyre civil; moshës, gjinisë, përgatitjes arsimore, statusit social dhe gjendjes ekonomike. Rrjedhimisht, nevojat e të riatdhesuarve nuk janë të njëjta sikurse që ndryshojnë edhe kapacitetet e tyre absorbuese dhe përkushtimi për riintegrim në shoqëri. Prandaj është e nevojshme që çdo të riatdhesuari t'i qasemi individualisht. Kjo situatë paraqet nevojën për profilizimin socio-ekonomik të personave të riatdhesuar në mënyrë që të bëhet më lehtë vlerësimi i nevojave të tyre dhe ofrimi i shërbimeve bazuar në nevojat e tyre.

Riintegrimi është një proces i ndërlikuar që përfshin ofrimin e ndihmës për personat e riatdhesuar duke filluar nga ndihma emergjente në momentin e arritjes, qasje në shërbime publike, shërbime të specializuara

për persona të cenusshëm, si dhe mbështetje për arritjen e riintegrit të qëndrueshëm. Gjatë periudhës kohore 2013-2016, janë mbështetur me asistencë të ndryshme nga programi i riintegrit 13,357 persona të riatdhesuar. Në vitin 2013, kanë përfutuar 2635 persona të riatdhesuar. Më 2014, numri i përfutuesve ishte 2,024, në vitin 2015 ishin 2912 përfutues, ndërsa më 2016, 5,786 përfutues. Numri i përfutuesve në 2016 ishte 50 % më i lartë sesa në vitet e kaluara. Vështruar sipas përfutjes së të kthyerve në skemat e përfutimit, 51 për qind të të kthyerve në total ishin përfutues në vitin 2013, 43 % e të kthyerve më 2014, 15 % e të kthyerve më 2015, si dhe 44 për qind në vitin 2016.

Nevoja për mbështetje në riintegrim gjatë vitit 2015 dhe më 2016 është rritur ndjeshëm si pasojë e kthimit masiv pas fluksit të migrimit në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015. Përkundër mbështetjes së një numri të madh të të kthyerve, edhe me tutje mbetet sfida riintegrimi i qëndrueshëm i të riatdhesuarve, posaçërisht i grupeve të cenusshme dhe personave me nevoja specifike. Fluksi i fundit i migrimit e ka ndryshuar ndjeshëm profilin dhe nevojat e personave të kthyer, e të cilat do të merren në konsideratë për t'u adresuar përmes kësaj Strategjie.

Figura 3: Numri i personave të riatdhesuar të mbështetur me masa të riintegrit 2013-2016



3. Faktorët që ndikojnë në riintegrim të qëndrueshëm

Gjatë hartimit të këtij dokumenti strategjik është bërë vlerësimi i strategjisë aktuale, janë konkluduar të arriturat dhe janë identifikuar sfidat që duhet adresohen në vitet në vijim. Gjithashtu është realizuar analiza e brendshme (SWOT), ku janë shqyrtuar përparësitë, mangësitë, mundësitë dhe rreziqet e procesit të riintegrit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar.

Procesi i analizës ka përfutur identifikimin e faktorëve kryesorë që ndikojnë në riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në të cilët është arritur progres substancial gjatë zbatimit të strategjisë aktuale. Këta faktorë janë: legjislacioni dhe politikat qeveritare, financimi, decentralizimi dhe roli aktiv i organeve komunale, sistemi për menaxhimin e rasteve dhe asistencë ndërkombëtare.

Korniza politike dhe qasja strategjike

Procesi i riintegrit paraqet arritje të rëndësishme që mund të karakterizohet si përparësi për zhvillim të mëtejshëm. Tashmë janë krijuar mekanizmat institucional të riintegrit, sistemi gjithëpërfuturës për riintegrim, strukturat institucionale mbështetëse, kadri ligjor dhe procedurat operative për riintegrim. Strategjia e Riintegrit e vitit 2013-2017 dhe Plani i Veprimt, Rregullorja për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, Rregullorja për themelimin e Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), Rregullorja për Funkionimin e Qendrës për Akomodimin e Personave të Riatdhesuar, Rregullorja për Subvencionimin e projekteve që promovojnë riintegrimin e personave të riatdhesuar në Republikën e Kosovës si dhe Udhëzimi për Ripranimin dhe Riintegrimin e Fëmijëve të Pashoqëruar, ofrojnë një kuadër gjithëpërfuturës rregullativ, i cili është i harmonizuar me politikat e Qeverisë së Kosovës dhe është bërë në përputhje me standardet dhe parimet ndërkombëtare.

Financimi

Për zbatimin e politikave të Riintegrit, Qeveria ndan buxhet të veçantë. Disbursimi i buxhetit të mjaftueshëm është me rëndësi në mënyrë që të adresohen kërkesat dhe nevojat e personave të riatdhesuar në fushat me prioritet, siç janë identifikuar në strategji dhe përcaktuar në kuadër të kornizës ligjore dhe administrative.

Raporti i Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave thekson, se: “Kosova përmbush të tri kriteret në fushën e riintegrit”¹⁰. Kosova ka përmbushur kërkesën e mbetur të ndarjes së fondeve të riintegrit, me fokus tek ofrimi i ndihmës në punësim, themelim të bizneseve të vogla, aftësime profesionale e kurse gjuhësore për fëmijë.

Në shtator 2010, Qeveria ka themeluar Fondin e Riintegrit për mbështetjen e riintegrit të qëndrueshëm të shtetasve kosovarë të riatdhesuar, duke e dedikuar buxhetin sipas viteve, për 2013 ka ndarë buxhetin prej 3,170,150.00, për vitin 2014 në shumë prej 2,372,450.04, për vitin 2015 në shumë prej 2,112,671.00, për vitin 2016 në shumë prej 2,001,719.00, për vitin 2017 në shumë prej 2,756,719.00 euro.

Decentralizimi dhe roli i organeve komunale

Strategjia e Riintegrit e vitit 2013-2017, fokusohet tek decentralizimi i kompetencave nga niveli qendror në nivelin lokal. Kompetencat lidhur me vendimmarrjen për përfitim nga skemat e riintegrit janë transferuar në mënyrë efektive në nivel lokal që nga viti 2013.

DRPR-ja, në mënyrë të vazhdueshme mbështet komunitat, në mënyrë që ato të marrin rol udhëheqës në riintegrimin e qëndrueshëm të të riatdhesuarve. Komunitat mbesin akterë kryesorë në riintegrim dhe kanë përgjegjësi për të ofruar shërbimet e riintegrit të definuar qartë për personat e riatdhesuar, si dhe për t'i kushtuar vëmendje të posaçme përfshirjes së tyre sociale e ekonomike brenda shoqërisë kosovare.

Sistemi për Menaxhimin e Rasteve (SMR)

SMR-ja ndihmon zbatimin dhe monitorimin e procesit të riintegrit. SMR është sistem elektronik që administrohet nga MPB-ja, ku të gjitha aplikacionet dhe të dhënat përkatëse në lidhje me personat e riatdhesuar si dhe përfitimet e tyre shënohen, ruhen, përpunohen dhe arkivohen. Përmes SMR, procesi i riintegrit të personave të riatdhesuar menaxhohet plotësisht që nga momenti i hyrjes në Kosovë e deri në përmbyllje të rastit, në pajtim me procedurat e përkufizuara në legjislacionin e politikave. ZKKK-të kanë qasje elektronike në SMR si dhe infrastrukturën e domosdoshme teknologjike për të regjistruar e përditësuar të dhënat.

Asistenca ndërkombëtare

Asistenca ndërkombëtare ka luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të riintegrit. Asistenca teknike kontribuon në avancimin e tërë sistemit të riintegrit, si dhe kapacitetet nacionale për të planifikuar, menaxhuar, monitoruar dhe përmirësuar vazhdimisht këtë sistem.

Faktorët tjerë, gjithashtu me rëndësi esenciale drejt integrit të qëndrueshëm, por të cilët janë vlerësuar *sfidues*, janë: sigurimi i efektshmërisë së masave për riintegrim, fuqizimi i autoriteteve komunale dhe bashkërendimi i partnerëve zbatues, si dhe ngritja e vetëdijes së publikut, harmonizimi i qasjeve institucionale ndaj zhvillimit socio-ekonomik, bashkëpunimi dhe koordinimi, shkëmbimi i informatave me shtetet kthyes, mbështetja e bazuar në nevojat të veçanta për grupet specifike dhe resurset financiare.

Sigurimi i efektshmërisë

Derisa janë decentralizuar shërbimet dhe përgjegjësitë në ofrimin e shërbimeve, është krijuar korniza dhe sistemi i riintegrit të të riatdhesuarve, në nivel komunal dhe në atë qendror ka vështirësi në të siguruarit e efektshmërisë. Në kuadër të zbatimit të kësaj Strategjie, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet fuqizimit dhe ruajtjes së kapaciteteve njerëzore institucionale, në nivel qendror dhe atë lokal.

¹⁰ Raporti i katërt i Progresit të Kosovës në përmbushje të kërkesave të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave SËD (2016) 160 final.

Riintegrimi i qëndrueshëm i personave të riatdhesuar kërkon nga ministrinë dhe komunat që të jenë aktive në bashkërendim të veprimeve në këtë proces dhe njëkohësisht të luajnë rol pro aktiv dhe të bëjnë vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut në këtë proces.

Të gjeturat nga monitorimi në terren, tregojnë se nevojitet një “*cikël i përmirësimit të vazhdueshëm*” për të ngritur kapacitetet e personelit të riintegrimit për të zbatuar Strategjinë e Riintegrimit. Si pjesë e këtij cikli, nevojat për kapacitete njerëzore do të plotësohen me anë të trajnimit të orientuar nga personeli, vlerësimit të nevojave dhe ndikimit që ndërlihen me zbatimin e strategjisë si dhe shfrytëzimin e vazhdueshëm të SMR-së për punën e përditshme të DRPR-së dhe zyrtarëve në komuna. Po ashtu, do të trajtohet me prioritet zhvillimi i kapaciteteve njerëzore në hartim dhe menaxhim të projekteve për financim nga donatorët e huaj, e sidomos projektet e IPA-së për Kosovën. Në nivel komunal, DRPR-ja do të mbështesë komunat në proces të hartimit të Planeve Komunale të Riintegrimit dhe zbatimit të tyre.

Harmonizimi i qasjes institucionale ndaj zhvillimit socio-ekonomik

Mjedisi institucional dhe politik për riintegrimin e qëndrueshëm të të kthyerve është kompleks dhe përfshin shumë akterë institucionalë. Është me rëndësi kritike që të sigurohet gatishmëria e institucioneve tjera për të harmonizuar politikat e tyre me kornizën e politikave të riintegrimit. Me rëndësi të veçantë për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në zona rurale do të ishte lehtësimi i qasjes se tyre për përfitim në grandet bujqësore që ndahen nga Ministria e Bujqësisë dhe komunat. Mungesa e bashkërendimit ndërmjet programeve dhe projekteve të ndryshme brenda sistemit të riintegrimit në Kosovë, shkakton rrezikun e dyfishimit të aktiviteteve, shfrytëzimit joefikas të resurseve dhe asistencën e pa monitoruar nga institucionet përgjegjëse shtetërore, e cila me ndihmën e shteteve financuese dhe mbështetjen e BE-së, duhet adresuar urgjent. Mungesa e prioritizimit të riintegrimit në komuna për të akomoduar të riatdhesuarit pas 12 muajsh mbështetjeje nga skemat e riintegrimit përbën barrë shtesë, gjë që kërkon masa efektive. Në veçanti, vonesat në ndërtimin dhe rindërtimin e njësisve banesore për përfituesit e riatdhesuar duhet shmangur në të ardhmen.

Shkëmbimi i informatave me shtetet kthyes

Mungesa e informatave për personat e riatdhesuar po e vështirëson në masë të madhe punën e DRPR-së në planifikimin, pritjen, ofrimin e shërbimeve bazuar në nevoja dhe riintegrimin e qëndrueshëm të të riatdhesuarve, veçanërisht në mbështetjen e grupeve të cënueshme, personave që një kohë të gjatë kanë jetuar jashtë Kosovës, personave me histori kriminale, të riatdhesuarit nga burgjet dhe personave me sëmundje të rënda. Po ashtu, mungesa e certifikatave të lindjes për fëmijët e lindur në shtetin prej nga kthehen, e pa mundëson regjistrimin civil të tyre, e në këtë mënyrë edhe riintegrimin e tyre.

Në mesin e të riatdhesuarve ka viktimat e trafikimit, persona që riatdhesohen drejtpërdrejt nga burgjet, persona me sëmundje të rënda infektive, persona të lindur e të rritur në shtetet prej nga kthehen duke lënë pas vetes histori të ndryshme dhe jetë të tërë, informata këto që zbulohen gjatë trajtimit të personave në proces të riintegrimit.

Marrja e informatave të nevojshme dhe në kohë nga shtetet kthyes, para se personat të riatdhesohen, janë të domosdoshme dhe mundësojnë kombinimin e programeve shtetërore për mbështetjen e viktimave të trafikimit, kombinimin e programit të riintegrimit me programin e risocializimit për personat me histori kriminale të riatdhesuar nga burgjet, sinjalizon ndërmarrjen e masave mbrojtëse për sigurinë e stafit që trajton personat me sëmundje të rënda infektive dhe ndihmon krijimin e profilit të personave që kanë lindur dhe jetuar në migracion. MPB-ja duhet të vendosë një sistem të qëndrueshëm efektiv të shkëmbimit të informatave me shtetet kthyes, që do të lehtësojë planifikimin e pritjes, ofrimin e shërbimeve dhe riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar.

Mbështetja e grupeve specifike

Grupet specifike janë grupet e veçanta të të riatdhesuarve, të cilat për shkak të karakteristikave të tyre kanë nevojë për mbështetje dhe trajtim të veçantë. Grupet specifike mund të përfitojnë nga skemat e riintegritit me qëllim të riintegritit të tyre të qëndrueshëm. Gjatë procesit të riintegritit të personave të riatdhesuar, vëmendje e veçantë do t'u kushtohet: nënave vetushqyese me fëmijë, fëmijëve pa përkujdesje të prindërve, fëmijëve të keqtrajtuar, fëmijëve me nevoja të veçanta, fëmijëve të pashoqëruar dhe fëmijëve të ndarë, të moshuarve pa përkujdesje familjare, personave me aftësi të kufizuar pa përkujdesje familjare, viktimave të dhunës familjare, viktimave të trafikimit me njerëz dhe të kthyerve nga zonat e konfliktit.

Përderisa është vendosur një sistem i qëndrueshëm i riintegritit, që nga momenti i arritjes së personave të riatdhesuar në PKKK, qasja e ofritit të shërbimeve bazuar në nevoja të veçanta për grupet specifike mbetet edhe më tutje sfidë e trajtimit të këtyre kategorive. Një qasje e tillë do të orientonte resurset aty ku nevojitet dhe do të mundësonte riintegrimin e qëndrueshëm.

Marrë parasysh, nevojat specifike për grupe të veçanta të të riatdhesuarve përfshirë edhe të kthyerit nga zonat e konfliktit, do të dizajnohen pakot standarde të mbështetjes për secilën kategori, do të punohet me të gjitha ministrinë e linjës dhe partnerët zbatues për të siguruar plotësimin e nevojave komplekse të të kthyerve, veçanërisht të grupeve të cënueshme. Për ta bërë këtë, do të merren në konsideratë aspektet e cënueshmerisë me të cilat përballen të kthyerit, si dhe shërbimet e specializuara të nevojshme për të mbështetur të riatdhesuarit e cënueshëm në momentin e kthimit të tyre në Kosovë. Për adresimin e të gjitha nevojave të kësaj kategorie, do të punohet ngushtë me shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare për zbatimin e projekteve të përbashkëta.

Bashkërendimi i partnerëve implementues

Procesi i riintegritit përbën sistem të ndërlikuar që zhvillohet në shumë nivele dhe që përfshin shumë akterë. Nevoja për bashkëpunim e bashkërendim mes palëve është tejet e madhe, jo vetëm në nivel qendror ndërmjet ministrive përkatëse, por edhe në nivel lokal dhe me organizata joqeveritare dhe organizatat e donatorë ndërkombëtarë. Kjo kërkon avancim edhe më të madh të mekanizmave të bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet palëve të ndryshme, nën koordinimin e DRPR-së.

DRPR-ja njihet dhe pranon rëndësinë dhe rolin e partnerëve implementues, jo shtetërorë si dhe avokuesit e ndryshëm, sidomos atyre në shoqëri civile. DRPR-ja është i përkushtuar ndaj dialogut dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile, për të zhvilluar e zbatuar programe specifike lokale në mbështetje të riintegritit të personave të riatdhesuar.

Vetëdijesimi i publikut

Fushatat e vetëdijesimit dhe të informimit publik, duhen zhvilluar më tutje. Kjo përfshin edhe diversifikimin dhe përforcimin e linjave të komunikimit për të informuar personat e riatdhesuar mbi të drejtat dhe mundësitë e tyre për riintegrim socio-ekonomik. DRPR-ja do të mbështesë mbajtjen e forumeve publike në nivel qendror e lokal; të organizojë fushata vetëdijesimi mbi kërcënimet dhe rreziqet e rimi-grimit të parregullt, si dhe të organizojë fushata informuese në shtetet kthyes me numrin më të madh të shtetasve kosovarë që pritet të riatdhesohen mbi mundësitë e tyre për riintegrim në Kosovë.

Financimi

Nevojat e personave të riatdhesuar po rriten dhe ndryshojnë në vazhdimësi. Viteve të fundit është rritur ndjeshëm numri i personave me nevoja për mbështetje nga skemat e riintegritit në përgjithësi. Në të njëjtën kohë po rritet në vazhdimësi numri i të kthyerve me nevoja specifike, kryesisht persona me probleme depresioni, sëmundje të rënda dhe persona të varur nga substancat supotropike. Meqë shërbimet shëndetësore publike ofrojnë shërbime të kufizuara në këtë fushë për shkak të kapaciteteve ende në zhvillim, kjo nevojë paraqet sfidë për buxhetin vjetor të riintegritit. Për të adresuar këtë problematikë, dhe për të ofruar shërbimet e nevojshme për këtë kategori, nevojitet një qasje e koordinuar mes

institucioneve qendrore e lokale shëndetësore, shoqërisë civile dhe donatorëve, që përmes projekteve të ndryshme të plotësohen këto nevoja të të riatdhesuarve dhe të mbështesin procesin e riintegrit. Këto projekte do të mundësonin edhe financimin e shërbimeve të cilat nuk ofrohen në institucionet publike, posaçërisht për grupet e cenushme.

Faktorët përtej fushëveprimit të ndikimit të Qeverisë së Kosovës

Faktorët përtej fushëveprimit të Qeverisë, e që kanë ndikim në kthim dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar, konsiderohen numri i personave që duhet të riatdhesohen dhe periudhat e riatdhesimit nga shtetet anëtare të BE-së. Po ashtu, zhvillimet politike në shtetet anëtare të BE-së që mund të ndikojnë në politikat e migrimit, ndikojnë edhe në situatën e kthimit të shtetasve kosovarë, e në këtë rast, edhe riintegrit.

2. VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar të promovojë shtetin demokratik, të sigurt e modern, me prosperitet, drejt arritjes së standardeve të larta jetësore evropiane. Duke marrë parasysh rëndësinë e procesit të riatdhesimit dhe ndikimit në jetën shoqërore-ekonomike, riintegrimi i personave të riatdhesuar është një prej prioriteteve të agjendës politike të Qeverisë.

Vizioni

Vizioni i Strategjisë së Riintegrimit është riintegrimi i qëndrueshëm i personave të riatdhesuar në Kosovë.

Misioni

Misioni i Strategjisë së Riintegrimit është të mundësojë riintegrim të qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar përmes avancimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të një sistemi efektiv e efikas të shërbimeve, të fokusuar në nevojat e të kthyerve.

Objektivat strategjike dhe specifike

Objektivat strategjike dhe specifike përbëjnë kornizën bazë për veprimet specifike në arritjen e rezultateve të synuara përmes kësaj Strategjie. Të gjitha objektivat janë në harmoni me kornizën përkatëse strategjike e ligjore, si dhe janë në përputhje me marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare si dhe agjendën evropiane.

Objektivi strategjik 1: Avancimi i sistemit të riintegrimit për personat e riatdhesuar duke aplikuar qasjen e orientuar në nevoja

Sistemi aktual i ofrimit të masave për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, kërkon avancim të mëtutjeshëm në mënyrë që t'u përgjigjet plotësisht nevojave specifike të grupeve të veçanta. Në adresimin e nevojave të veçanta të grupeve specifike, rol të rëndësishëm ka sigurimi i informatave adekuate për të riatdhesuarit nga shtetet kthyesë, mekanizmat adekuate për identifikimin e personave me nevoja specifike, referimi i rasteve tek autoritetet përgjegjëse, vlerësimi i nevojave dhe zhvillimi i pakove standarde të riintegrimit për secilën kategori duke aplikuar qasjen e orientuar në nevojat specifike të secilit grup përfshirë personat e kthyer nga zonat e konfliktit. Këto masa paraqesin objektivat specifike të cilat janë elaboruar me planin e veprimit.

Objektivi specifik 1.1: Sigurimi i të dhënave adekuate dhe në kohë nga shtetet kthyesë në lidhje me personat e riatdhesuar për nevoja të riintegrimit;

Objektivi specifik 1.2: Kthimi i sigurt dhe me dinjitet i kosovarëve që nuk kanë të drejtë qëndrimi në shtetin nga i cili kthehen, pritja e organizuar, këshillimi dhe referimi i tyre në shërbimet emergjente në momentin e arritjes;

Objektivi specifik 1.3: Zhvillimi i pakove standarde të shërbimeve të riintegrimit dhe sigurimi i shërbimeve cilësore, për secilën kategori të personave të riatdhesuar;

Objektivi specifik 1.4: Avancimi i sistemit të riintegrimit të qëndrueshëm të grupeve të cënueshme duke aplikuar qasjen e orientuar në nevojat specifike për secilin grup;

Objektivi specifik 1.5: Zhvillimi i sistemit për riintegrim të suksesshëm të personave të riatdhesuar nga zonat e konfliktit.

Objektivi strategjik 2: Riintegrimi i qëndrueshëm socio-ekonomik i personave të riatdhesuar

Përkundër të gjitha përpjekjeve të gjertanishme dhe investimeve të madha njerëzore dhe financiare në ri-integrimin e personave të riatdhesuar, riintegrimi i qëndrueshëm është një gjendje vështirë e arritshme. Masat e riintegrimit paraqesin një mekanizëm të rëndësishëm në mbështetje të personave të riatdhesuar, por praktika tregon se ndikimi i tyre ende mbetet i kufizuar.

Me qëllim të avancimit të mbështetjes për personat e riatdhesuar dhe kontributi në riintegrim të qëndrueshëm, fokusi i masave në vitet e ardhshme do të jetë në avancimin e sistemit të referimit të rasteve në skemat adekuate të riintegrit, analizimin e profilit të riatdhesuarve dhe avancimin e masave të riintegrit të qëndrueshëm ekonomik, avancimit të sistemit për riintegrim të qëndrueshëm social, rritja e mundësive për arsim dhe aftësim profesional gjatë gjithë jetës dhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve në lidhje me rreziqet e migrimit dhe rimigrimit jo të rregullt. Fuqizimi i institucioneve lokale të përfshira në proces të riintegrit, si parakusht për riintegrim të qëndrueshëm, do të ketë fokus të veçantë në kuadër të avancimit të sistemit dhe masave të parapara me këtë strategji. Këto masa përbëjnë objektivat specifike që janë të reflektuara më poshtë dhe janë të adresuara me aktivitete konkrete të planifikuara në planin e veprimit të kësaj strategjie.

Objektivi specifik 2.1: Avancimi i sistemit të referimit të rasteve në skemat adekuate të riintegrit;

Objektivi specifik 2.2: Avancimi i masave të riintegrit të qëndrueshëm ekonomik;

Objektivi specifik 2.3: Avancimi i sistemit për riintegrim të qëndrueshëm social të personave të riatdhesuar;

Objektivi specifik 2.4: Përfshirja e personave të riatdhesuar në të mësuarit gjatë gjithë jetës;

Objektivi specifik 2.5: Vetëdijesimi i publikut.

Objektivi Strategjik 3: Avancimi i bashkëpunimit gjithëpërfshirës në fushën e riintegrit

Avancimi i bashkëpunimit me institucionet përkatëse në nivel ndërkombëtar dhe rajonal do të vazhdojë të jetë prioriteti i kësaj strategjie në përgjigje të fluksit të kthimit dhe nevojave të riintegrit. Gjatë periudhës së ardhshme, në fokus do të jetë shkëmbimi i informatave relevante me shtetet kthyesë, shfrytëzimi dhe koordinimi i asistencës së ofruar nga institucionet ndërkombëtare dhe donatorët e ndryshëm. Për të siguruar rrjedhë dhe kualitet të ofrimit të asistencës së nevojshme dhe riintegrim të qëndrueshëm, veprime specifike janë planifikuar për të intensifikuar bashkëpunimin mes institucioneve relevante në nivel horizontal dhe vertikal. Këto masa janë përcaktuar në objektivat e mëposhtme specifike:

Objektivi specifik 3.1: Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar e rajonal;

Objektivi specifik 3.2: Avancimi i bashkëpunimit horizontal e vertikal ndërmjet akterëve të përfshirë në procesin e riintegrit;

Objektivi specifik 3.3: Koordinimi i ndihmës financiare dhe teknike.

Objektivi Strategjik 4: Fuqizimi i kapaciteteve për sigurimin e një qasje të integruar në sistemin e riintegrit

Procesi kompleks i riintegrit kërkon resurse, kapacitete dhe ekspertizë specifike të qëndrueshme, e cila mund të arrihet vetëm me investim të vazhdueshëm në kapacitetet e stafit të involvuar në riintegrim, në nivel lokal dhe atë qendror. Avancimi i procesit të riintegrit dhe adresimi i nevojave specifike të grupeve të veçanta, kërkon aftësi të stafit në trajtimin e këtyre kategorive dhe ofrimin e shërbimeve bazuar në nevoja. Fuqizimi i kapaciteteve për sigurimin e një qasje të integruar, bazuar në nevoja, synohet të arrihet duke realizuar objektivat e mëposhtme specifike:

Objektivi specifik 4.1: Zhvillimi i moduleve përkatëse për ngritjen e kapaciteteve për stafin e përfshirë në procesin e riintegrit;

Objektivi specifik 4.2: Zhvillimi i kapaciteteve për menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit të riintegrit në të gjitha nivelet;

Objektivi specifik 4.3: Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira;

Objektivi specifik 4.4: Fuqizimi i kapaciteteve të stafit të përfshirë në procesin e riintegrit për trajtim të grupeve të cënueshme;

Objektivi specifik 4.5: Fuqizimi i sistemit të riintegrit në nivelin lokal.

Objektivi Strategjik 5: Fuqizimi i monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të politikave të riintegrit

Progresi drejt riintegrit të qëndrueshëm bëhet duke zbatuar masat e parapara me legjislacion dhe politika përkatëse, por edhe duke monitoruar zbatimin e tyre dhe ndikimin që ato kanë në arritjen e qëndrueshmërisë së riintegrit. Monitorimi dhe vlerësimi i gjithë procesit të riintegrit të qëndrueshëm paraqet synim afatgjatë, i cili nuk kufizohet në menaxhimin e rasteve, por ndikimin e masave në procesin e riintegrit në tërësi dhe rolin e të gjithë akterëve të involvuar. Ky proces i gjerë i monitorimit dhe i vlerësimit kërkon mekanizma adekuat siç është Platforma gjithëpërfshirëse e monitorimit dhe vlerësimit, modalitete dhe kapacitete të veçanta për vlerësimin e rezultateve të të gjithë akterëve siç janë paraqitur në objektivat e mëposhtme specifike:

Objektivi specifik 5.1: Zhvillimi i një platforme gjithëpërfshirëse të monitorimit të procesit të riintegrit dhe vlerësimi i rezultateve;

Objektivi specifik 5.2: Zhvillimi i sistemit të integruar të raportimit;

Objektivi specifik 5.3: Avancimi i E-Sistemit të Menaxhimit të Rasteve të riintegrit;

Objektivi specifik 5.4: Monitorimi sistematik i qasjes së orientuar në nevoja për secilën kategori të personave të riatdhesuar, bazuar në planin individual të riintegrit.

Alternativat e shqyrtuara

Gjatë procesit të hartimit të kësaj Strategjie, janë trajtuar disa alternativa të orientimit të politikave për sigurimin e riintegrit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar.

Alternativa e parë, e shqyrtuar, është bazuar te ofrimi i shërbimeve për riintegrim të qëndrueshëm të të gjithë të riatdhesuarve . Kjo alternativë ka kosto të lartë financiare, nuk bazohet në nevojat e personave të riatdhesuar si dhe mund të shkaktojë pakënaqësi tek popullata rezidente e Kosovës dhe përjashtim social të personave të riatdhesuar.

Alternativa e dytë, ishte të ofrohen shërbime të riintegrit vetëm për grupet e cenueshme. Kjo alternativë do të përjashtonte shumë kategori të të kthyerve, veçanërisht të rinjtë dhe personat që kanë nevoja të ndryshme si: aftësim profesional, punësim apo shkollim, edhe pse nuk kategorizohen si të cenueshëm.

Alternativa tjetër, e cila është përzgjedhur për hartimin e kësaj Strategjie, bazohet te ofrimi i shërbimeve, në përputhje me nevojat e të riatdhesuarve, si dhe aplikon qasje të përshtatur përball nevojave për riintegrim të qëndrueshëm.

3. ZBATIMI

Riintegrimi i personave të riatdhesuar mbështetet nga: pritja e organizuar dhe ndihma e menjëhershme pas arritjes, përfitimet emergjente dhe masat që mbështesin riintegrimin e qëndrueshëm.

Shërbimet që ofrohen për personat e riatdhesuar përfshijnë pritjen e organizuar dhe asistencën menjëherë pas arritjes, informimin e të riatdhesuarve për të drejtat e tyre, ndihma pas arritjes, strehimi i përkohshëm në Qendrën e Akomodimit, përfitimet emergjente dhe masat për riintegrim të qëndrueshëm. Pas arritjes së të riatdhesuarit në komunën e origjinës vlerësohen nevojat dhe ofrohen për riintegrim të qëndrueshëm.

Masat për riintegrim të qëndrueshëm, në parim, përfshijnë mbështetjen për të riatdhesuar në qasjen e tyre në shërbimet publike. Bazuar në nevojat e tyre, ata mund të përfitojnë nga skemat specifike që ofrohen në kuadër të ndihmës dhe mbështetjes për kthim të qëndrueshëm që financohen në kuadër të masave të riintegrit.

Regjistrimi civil dhe pajisja me dokumente identifikimi personat e riatdhesuar është parakusht që u mundëson të riatdhesuarve përfitimet tjera nga masat e riintegrit dhe bëhet në harmoni me legjislacionin në fuqi. Posedimi i dokumenteve civile është esenciale për gëzimin e të drejtave sociale, ekonomike dhe politike. Problemet e mungesës së dokumentacionit të nevojshëm për regjistrim civil do të adresohen në kudër të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me shtetet dërguese .

Kujdesi shëndetësor për personat e riatdhesuar ofrohet përmes sistemit të institucioneve shëndetësore publike në nivel primar, dytësor dhe terciar. Personat e riatdhesuar, me nevoja të veçanta shëndetësore, mund të përfitojnë asistencë në kompensimin e shpenzimeve për barëra të cilat nuk përfshihen në listën esenciale të barërave (LEB).

Kujdesi shëndetësor për të riatdhesuarit është çështje shqetësuese gjatë procesit të riintegrit, sidomos mungesa e informatave për të kthyerit me shëndet të përkeqësuar apo cenueshmëri.

Qendrat e Mjekësisë Familjare, në nivele komunale, janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe obligohen të zbatojnë me prioritet masat e kujdesit shëndetësor për personat e riatdhesuar edhe në rastet kur ata nuk posedojnë dokumentacionin e nevojshëm për shkak të gjendjes civile të tyre.

Kthimi i personave me probleme të **shëndetit mendor, përdoruesve të substancave suptropike** dhe atyre me nevoja të veçanta, paraqet sfidë për shkak të kapaciteteve të limituara në institucionet e specializuara mjekësore për trajtimin e tyre. Po ashtu, stigmatizimi i kësaj kategorie në shoqëri e bën edhe më të rëndë gjendjen e tyre. Në vitet në vijim do të ndërmerren masat adekuate të ngritjes së vetëdijes së publikut për nevojat e kësaj kategorie dhe, përmes partneriteti, organizatat dhe shoqërinë civile do të sigurojnë shërbimet specifike të trajtimit psiko - social për personat me nevojë.

Banimi është e drejtë sociale e qytetarëve në shumicën e vendeve të zhvilluara, sepse është vendimtar për shëndet dhe zhvillim kualitativ të jetesës. Komunitat janë autoriteti përgjegjës për ofrimin e zgjidhjeve të banimit social, sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të ndërlidhur me Ligjin për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit. Komunitat duhet të ofrojnë zgjidhje të qëndrueshme banimi për personat e riatdhesuar që kanë nevojë për siguri të banimit gjatë procesit të riintegrit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ndihmon komunitat në hartimin e politikave të banimit si dhe në planifikimin e buxheteve që mbështesin programet e banimit, duke përfshirë programet e banimit social, në bazë të nevojave dhe prioriteteve të identifikuara.

Shumë nga të riatdhesuarit nuk kanë zgjidhje banimi kur kthehen në Kosovë, dhe krijimi i zgjidhjeve të qëndrueshme banesore ka rëndësi madhore në kuptimin e përfshirjes sociale.

Bazuar në gjendjen aktuale të personave të riatdhesuar, në shumicën e rasteve ata kërkojnë strehim emergjent/të përkohshëm dhe ofrim të banimit me qira (bonus banimi)¹¹. Fonde të caktuara nga buxheti i riintegrit shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet e qirasë, rindërtimin, renovimin apo mobilimin e njësisve banesore të dedikuara për personat e riatdhesuar. Sfidë edhe me tutje mbetet banimi i qëndrueshëm i tyre si pasojë e mungesës së kapaciteteve në nivel lokal. Komunat në bashkëpunim me MMPH do të trajtojnë me prioritet nevojat e banimit të kategorive të cenueshme, përfshirë të riatdhesuarit.

Arsimi është e drejtë themelore dhe të gjithë fëmijët e riatdhesuar kanë të drejtë të ndjekin shkollimin në sistemin publik shkollor të Kosovës. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), mbështet Departamentet Komunale për Arsim (DKA-të) për përfshirjen e fëmijëve të riatdhesuar në sistemin arsimor, por edhe në krijimin e kushteve dhe mundësive që ndërliken me nivelin e caktuar të shkollimit të tyre.

Shumë persona të riatdhesuar kanë kaluar periudhë të gjatë kohore jashtë vendit, madje disa prej tyre janë lindur dhe arsimuar në vendet prej nga kthehen. Për të rinjtë, posaçërisht për fëmijët, kjo nënkupton që ata shpesh nuk kanë njohuri të ndonjëres nga gjuhët zyrtare në Kosovë, e që rezulton me vështirësitë për qasje në arsimim, trajnim dhe punësim pas kthimit. Qasja në asistencën sociale, mjekësore dhe shërbimet tjera publike është vështirësuar për ata të cilët nuk mund të komunikojnë në ndonjërin nga gjuhët zyrtare. Vështirësi gjatë riintegrit, po ashtu paraqesin edhe mungesa e certifikatave/diplomave për të dëshmuar nivelin e edukimit në vendet nikoqire. Vëmendje te veçantë kërkojnë fëmijët me nevoja të veçanta.

Për të adresuar sfidat gjithëpërfshirëse në arsimin e detyruar, në kuadër të DKA-ve, në komuna do të certifikohen trajnerët për trajnimin e stafit mësimor në shkolla për trajtimin e të kthyerve, organizimin e kurseve të gjuhës dhe mësimin plotësues për nxënësit e riatdhesuar. Për fëmijët e riatdhesuar, të cilët kanë nevojë për kurse të gjuhës dhe mësim plotësues, do të punohet nga stafi mësimor, bazuar në një plan individual i përgatitur nga specialistë arsimor të shkollës ku fëmija e ndjek mësimin. Po ashtu, përmes ekipeve të reagimit kundër braktisjes së shkollave do të evitohet braktisja e shkollave, si fenomen aktual veçanërisht për komunitetin rom, ashkali egjiptian.

Krahas shkollimit do të organizohen aktivitete kulturore e argëtuese, me qëllim të lehtësimit të integrit kulturor dhe shoqërimin të fëmijëve me bashkëmoshatarët e vet, e cila ndikon pozitivisht në riintegrim të suksesshëm të fëmijëve pas riatdhesimit.

Integrimi i personave të riatdhesuar në tregun e punës bëhet përmes shërbimeve publike të punësimit, përfshirë masat aktive të tregut të punës. **Aftësimi profesional** u ofrohet të gjithë personave të riatdhesuar, të cilët kanë nevojë për përgatitje profesionale për përfshirje në tregun e punës. **Trajnimi në vend të punës** ofron mundësi për avancim të shkathtësive në vendin e punës, dhe rrit mundësitë që personat e trajnuar të mbesin të punësuar, pas përfundimit të praktikës. Punësimi përmes **subvencionimit të pagës** ka për qëllim gjenerimin e mundësisë së punësimit për personat e riatdhesuar, të regjistruar si të papunë.

Vetëpunësimi dhe promovimi i ndërmarrësisë paraqet një masë të rëndësishme të vetëpunësimit dhe punësimit familjar të personave të riatdhesuar, më qëllim të mbështetjes së ndërmarrjeve me bazë në familje. Buxhet i veçantë sigurohet për riintegrim të qëndrueshëm ekonomik të riatdhesuarve, përmes subvencionimit të pagës, financimit të themelimit të biznesit. Ndihej që ofrohet për themelimin e biznesit paraqet masë kyçe që të riatdhesuarit të gjenerojnë të ardhura për riintegrimin e tyre të qëndrueshëm.

Qasja në shërbimet e punësimit dhe masa aktive të tregut të punës (MATP), për personat e riatdhesuar të regjistruar si punëkërkues në zyrat e punësimit, mbështetet nga Zyrat e Punësimit, që është parakusht për të përfutur nga MATP-të. Rëndësi te veçantë gjatë viteve në vijim do t'i kushtohet analizave të nevojave të

¹¹ Akomodim me qira- në 2013 kanë përfutur 969, in 2014 kanë përfutur 842, in 2015 kanë përfutur 639, ne 2016 kanë përfutur 737. Rindërtim/renovim në vitin 2013 kanë përfutur 56, in 2014 kanë përfutur 24, në 2015 kanë përfutur 5, në 2016 kanë përfutur 11. Mobilim i shtëpive- në 2013 kanë përfutur 23, në 2014 kanë përfutur 17, në 2015 kanë përfutur 17, in 2016 kanë përfutur 24.

tregut të punës dhe *përshtatshmëria e fushave të aftësimit profesional* me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës.

Për arritjen e rezultateve më të mira për riintegrimin e qëndrueshëm ekonomik, **profilizimi dhe këshillimi në karrierë** do të ofrohet për kandidatët në bazë të nevojave të tregut të punës.

Përfitimi nga grandet bujqësore në nivel qendror dhe komunal - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) harton dhe zbaton politika agro-rurale, me qëllim të sigurimit të mundësive të punësimit dhe krijimit të të ardhurave për qytetarët që jetojnë në zona rurale.

Në kuadër të avancimit të skemave për mbështetje për riintegrim të qëndrueshëm, personat e kthyer në zona rurale do të kenë mundësi të përfitojnë grande bujqësore. MBPZHR, në bashkëpunim me MPB-DRPR, do të zhvillojë procedurat e nevojshme për sigurimin e qasjes në grande bujqësore për personat e riatdhesuar në zona rurale.

MBPZHR dhe DRPR do të adresojnë çështjen e përfitimit të granteve të vogla bujqësore në nivel komunal në Drejtoritë Komunale Bujqësore, me qëllim të rritjes së mundësive të përfitimit për këtë kategori të shoqërisë.

Shërbimet sociale janë të drejta kushtetuese për secilin person i cili jeton në Kosovë me qëndrim të përhershëm apo qëndrim afatshkurtër duke përfshirë personat e riatdhesuar. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) bën hartimin e politikave sociale dhe skemave pensionale, monitoron dhe inspekton shërbimet e ofruara nga Qendrat për Punë Sociale (QPS). Shërbimet sociale përfshijnë ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit, ose në raste të veçanta ndihmë materiale për njerëzit në nevojë sociale. QPS në secilën komunë është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale. QPS zbaton politikat sociale dhe raportojnë për shërbimet e ofruara në MPMS, gjegjësisht Departamentit të Politikave Sociale dhe Familjes (DPSF).

Për qasjen në shërbimet sociale, grupet e cënueshme janë definuar si grup që kanë nevojë për trajtim dhe mbështetje specifike krahasuar me popullatën e përgjithshme, të cilët shpesh ballafaqohen me vështirësi që mund të kenë për pasojë përjashtimin social.

Aspekti psiko-social i riatdhesimit përfshin problemet e adaptimit në kushte të riatdhesimit rrjedhin nga ankthi dhe pasiguria e përjetuar me rastin e kthimit. Procesi i adaptimit kërkon kohë dhe qasje gjithëpërfshirëse duke qenë se personat e riatdhesuari janë më fragjil në gëzimin e të drejtave të tyre sociale. Ata bëhen pjesë e popullatës përsëri, çka edhe kërkon shumë përpjekje për përfshirje në tregun e punës, adaptim socio-kulturor dhe psikologjik. Përshtatja socio-kulturore i atribuohet stilit të jetës, përfshirjes sociale, marrëdhënieve ndër njerëzore, kushteve financiare dhe adaptimit të kulturës në vendlindje. Në anën tjetër, ndikimi psikologjik i kthimit është i lidhur ngushtë me pritjet, stresin dhe perceptimin e humbjes së rrethit social. Prandaj, eksperiencia e riatdhesimit është individuale dhe kërkon qasje dhe trajtim individual psikosociale për riintegrim të qëndrueshëm.

QPS-të përkatëse do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme në kohën më të shkurtër të mundshme, që të ju mundësojë personave të riatdhesuar përfshirje në shërbime sociale në përputhje me legjislacionin përkatës të aplikueshëm.

4. GRUPET E CENUESHME

Strategjia e Riintegrit të Personave të Riatdhesuar 2018-2022 vendos fokus të veçantë në avancimin e masave të riintegrit për grupet e cenueshme duke ofruar asistencë bazuar në nevojat e tyre.

Grupet e Cenueshme (GC) janë personat e riatdhesuar të cilët kanë nevojë për masa të veçanta të riintegrit si pasojë e kapacitetit të tyre të zvogëluar funksional, për shkak të sëmundjes apo aftësive të kufizuara, apo si pasojë e gjendjes së tyre familjare, gjinisë, moshës, analfabetizmit apo arsyeve të ngjashme, ose personat të cilëve u mungojnë njohuritë adekuate të gjuhëve zyrtare të Kosovës.

Grupet e cenueshme janë grupe të veçanta të të riatdhesuarve të cilat për shkak të karakteristikave të tyre kanë nevojë për mbështetje dhe trajtim të veçantë. Gjatë procesit të riintegrit të personave të riatdhesuar vëmendje e veçantë do t'u kushtohet: nënave vetushqyese me fëmijë, fëmijëve pa përkujdesje të prindërve, fëmijëve të keqtrajtuar, fëmijëve me nevoja të veçanta, fëmijëve të pashoqëruar dhe fëmijëve të ndarë, të moshuarve pa përkujdesje familjare, personave me aftësi të kufizuara pa përkujdesje familjare, viktimave të dhunës familjare, viktimave të trafikimit me njerëz dhe të kthyerve nga zonat e konfliktit.

Nënat vetushqyese me fëmijë paraqesin kategori të cenueshme në shoqërinë kosovare. Shkalla e papunësisë në Kosovë është e lartë, dhe në veçanti për nënat vetushqyese, ato jetojnë në gjendje të rëndë ekonomike, kanë mundësi të vogla të punësimit dhe prioritetet e tyre lidhen me rregullimin e çështjes së banimit, përmirësimin e kushteve për jetesë, ndihmë financiare nga shteti, etj¹².

Ligji për Barazi Gjimore garanton barazinë midis gjinive dhe ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndalon diskriminimin në baza gjimore. Ligji i Punës, obligon punëdhënësi që të krijojnë kushte të barabarta për të dy gjinitë, por edhe të respektojnë pushimin e lehonisë. Ligji për Trashëgiminë i Kosovës thekson se gratë dhe burrat kanë të drejta të barabarta në trashëgimi. Ndërkaq, dispozita më specifike lidhur me nënat vetushqyese përmban Ligji për Skemën e Ndhmës sociale në Kosovë¹³. Sipas nenit 3.1 të këtij ligji, "skema e ndihmës sociale ofron ndihmë financiare familjeve të përzgjedhura në përputhje me kriteret e parapara në këtë ligj dhe në bazë të mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës". Ligji për familjen i Kosovës parasheh që nënës dhe fëmijës t'u sigurohet mbrojtje e posaçme me mjete të mirëqenies sociale. Sipas këtij ligji përgjegjësia prindërore përfshin të drejtat dhe detyrat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirëritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë.

Marrë parasysh vulnerabilitetin e kësaj kategorie, si persona të riatdhesuar dhe nevojave specifike që kanë, institucionet e përfshira në riintegrim kanë prioritetizuar nevojat e tyre dhe do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë standardeve të trajtimit dhe zhvillimin e pakove të veçanta të ndihmës që u përshtatet nevojave të tyre. Këto masa janë reflektuar në objektivat strategjike dhe planin e veprimit të kësaj strategjie.

Për shumë *fëmijë të riatdhesuar*, qofshin ata nën shoqërimin e prindërve apo të pashoqëruar, riintegrimi i tyre është proces i vështirë, kërkon vëmendje dhe masa specifike të përshtatura me moshën dhe specifikat e secilit fëmijë. Qëndrimi jashtë shtetit dhe riatdhesimi kanë ndikim të madh në jetën e tyre. Hulumtimet tregojnë se një numër i konsiderueshëm i fëmijëve të kthyer kanë nevojë për asistencë të veçantë dhe /apo trajtim për t'i ndihmuar ata të përballen me vështirësi emocionale si pasojë e ndryshimeve në jetën e tyre. Një studim i realizuar gjatë vitit 2014 tregon se 37% e fëmijëve të riatdhesuar¹⁴ vuajnë nga problemet emocionale dhe pengesat në integrim social si rezultat i procesit të kthimit. Kjo shpesh rezulton në braktisjen apo performancën e dobët në shkollë, izolimin dhe përkeqësimin e shëndetit mental.

¹² Më pak pengesa, më shumë mundësi për nënat vetushqyese, Raport i KDI (2017)

¹³ Ligji Nr.2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, GZK, linku <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2460>.

¹⁴ Monitoring returned minors, Hit Foundation (2014)

Këto specifika vendosin fëmijët e riatdhesuar përfshirë në listën e prioriteteve të institucioneve përgjegjëse dhe i kushtohet vëmendje e veçantë trajtimit të tyre, ofrimit të mbështetjes nga skemat e riintegritimit që përfshijnë qasjen në kujdesin e duhur shëndetësor, mbështetja e prindërve apo kujdestarit për rritjen e fëmijëve, qasja në arsim, përkujdes psikologjik, angazhim në aktivitete grupore etj., duke respektuar plotësisht parimin e interesit më të mirë të fëmijës dhe parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Fëmijët e pashoqëruar trajtohen me kujdes të veçantë gjatë procesit të ripranimit dhe riintegritimit. Asistenca për fëmijët e pashoqëruar ofrohet bazuar në vlerësimin e nevojave në të gjitha rastet, me përjashtim të kufizimeve kohore¹⁵.

Që nga përfundimi i luftës në Kosovë, ka rritje të numrit të *personave të moshuar pa përkujdesje familjare*. Shtëpia për Persona të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare ka kapacitet të kufizuar për akomodimin e personave të moshuar pa përkujdesje familjare të riatdhesuar që nga momenti i kthimit.¹⁶ Institucionet e përfshira në riintegrim të personave të riatdhesuar që bëjnë pjesë në këtë kategori, do t'i kushtojnë vëmendje specifike nevojave të kësaj kategorie, duke zhvilluar pako standarde të mbështetjes dhe programe të veçanta të përkujdesjes deri në riintegrim të plotë të tyre në Shtëpinë për Persona të Moshuar në koordinim dhe bashkëveprim me MPMS-në.

Femrat vazhdojnë të jenë *viktima të dhunës familjare* në Kosovë¹⁷. Gratë të cilat përjetojnë dhunë fizike dhe psikologjike në të shumtën e rasteve nga bashkëshorti, nuk gëzojnë përkujdesje të mjaftueshme institucionale. Kosova ka krijuar mekanizma legjislativ me standarde evropiane sa i përket mbrojtjes ndaj dhunës në familje, por ende ka sfida të zbatimit në mungesë të strehimoreve dhe përkujdesjes adekuate.

Marrë parasysh këto rrethana, masat e riintegritimit të personave të riatdhesuar që bëjnë pjesë në këtë grup ofrohen me prioritet duke akomoduar nevojat e tyre përmes pakove standarde të shërbimeve, koordinimit dhe bashkërendimit me institucione të specializuara dhe duke ofruar trajtim sipas standardeve të zbatueshme në Kosovë.

Po ashtu, *Viktimat e trafikimit me njerëz*, shpeshherë hasen në terren gjatë vlerësimit të nevojave dhe trajtimit të personave të riatdhesuar. Autoritetet raportojnë se gratë që shfrytëzohen për prostitucion dhe fëmijët që detyrohen të punojnë, janë dy profilet më të shfrytëzuara. Sipas tyre, gjatë një viti, raportohen më shumë se 30 viktima të trafikimit. Policia e Kosovës ka radhatur dukurinë e trafikimit me njerëz si një nga kërcënimet kryesore në kuadër të vlerësimit të rreziqeve dhe kërcënimeve nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda. Faktorët kryesorë që nxisin trafikimin, janë gjendja socio-ekonomike, mungesa e kujdesit prindëror e familjar, në veçanti ndaj fëmijëve, si dhe braktisja e shkollimit.

Karakterit ndërkufitar dhe specifikat e viktimave të këtij krimi i bëjnë personat e riatdhesuar që janë pjesë e kësaj kategorie të cenueshme top prioritet për institucionet e përfshira në riintegrim në ofrimin e masave adekuate mbështetëse. Këto masa të riintegritimit do të jenë pjesë e pakove standarde të cilat do të zhvillohen në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislativin në fuqi dhe do të ndërliken në bashkëveprim me pakot e riintegritimit të viktimave të trafikimit, në të gjitha rastet e kthimit të viktimave të trafikimit përmes procesit të riatdhesimit, në bashkëpunim të ngushtë me Institucionet e specializuara në këtë fushë.

Personat e kthyer nga zonat e konfliktit paraqesin një tjetër kategori të ndjeshme në mesin e personave të kthyer. Kthimi dhe Rrintegrimi i suksesshëm i personave të kthyer nga zonat e konfliktit kërkon vëmendje

¹⁵ Gjatë vitit 2015 dhe 2016 nga skemat e riintegritimit kanë përfituar 151 familje nga grupet e cenueshme. Sipas kategorive të grupeve të cenueshme, kanë përfituar 33 nëna vetëushqyese me fëmijë, 27 persona me aftësi të kufizuar fizike dhe probleme shëndetësore, 5 me probleme mendore, 67 që jetojnë në kushte të rënda ekonomike, 3 persona të moshuar të vetmuar pa përkujdesje familjare, 10 nga komunitetet minoritare, 1 person që nuk flet gjuhët zyrtare dhe 5 persona pa liri të lëvizjes për shkak të problemeve familjare.

¹⁶ Shtëpia për përkujdesjen ndaj personave të moshuar pa përkujdesje familjare ka 135 shtretër.

¹⁷ Gjatë vitit 2016 janë raportuar 1226 raste të dhunës në familje, ku viktimat femra kanë qenë 988, e viktimat meshkuj kanë qenë 259 ndërsa në gjashtëmuorin e parë të vitit 2017 janë raportuar gjithsej 581 raste të dhunës familjare.

të veçantë në të gjitha aspektet. Krahas vendeve tjera edhe Kosova po përballet me fenomenin e pjesëmarrjes së kosovarëve në luftërat e huaja, të cilët në zonat e konfliktit po udhëtojnë të shoqëruar nga bashkëshortet dhe fëmijët e tyre. Familjaret e tyre me rastin e kthimit do të kenë nevojë për mbështetje nga shteti për riintegrim të serishëm në jetën politike, ekonomike e sociale pas riatdhesimit.

Institucionet përgjegjëse duhet të jenë të përgatitura dhe do të operojnë në bazë të një plani operativ për t'u përballur me nevojat e këtyre familjareve pas kthimit.

Riintegrimi i kesaj kategorie po paraqet një sfidë të re, madje edhe për shtetet me të zhvilluara, e cila duhet adresuar urgjent që këta persona mos të mbesin pa përkrahje nga shteti, pas kthimit.

Si masë për mbështetje të kësaj kategorie do të zhvillohet plani i reagimit nën udhëheqjen e MPB-së, do të vendoset sistemi efektiv i trajtimit në kuadër të sistemit të riintegrimin, dhe do të dizajnohen pakot standarde të mbështetjes, që i përshtatet nevojave specifike të tyre.

Personat e kthyer nga Institucionet korrektuese paraqesin një kategori të personave të cilët kthehen drejtpërdrejt nga institucionet korrektuese pas vuajtjes së dënimit, që, po ashtu, kërkojnë masa specifike, adekuate të riintegrimin në shoqërinë kosovare pas kthimit. Qëndrimi i gjatë i tyre në institucionet e vuajtjes së dënimit, e kaluara kriminale dhe shkëputja për një kohë të gjatë nga zhvillimet jashtë, e vështirësojnë ndjeshëm riintegrimin e suksesshëm të tyre në shoqëri, veçanërisht të personave të dënuar për vepra të rënda penale.

Bashkëpunimi me institucionet e sigurisë dhe organizatat e specializuara duke kombinuar pakot standarde të riintegrimin me pakot e rehabilitimit të personave pas vuajtjes së dënimit, paraqesin një aspekt të rëndësishëm të riintegrimin të suksesshëm e të qëndrueshëm të kësaj kategorie që duhet të aplikohet në vazhdimësi.

Në kuadër të zbatimit të kësaj Strategjie, MPB/DRPR është e përkushtuar të punojë me të gjitha ministritë e linjës, komunat dhe partnerët zbatues vendor e ndërkombëtar për të siguruar plotësimin e nevojave komplekse të te riatdhesuarve që i takojnë kategorive të veçanta.

Një përkushtim dhe angazhim në vete, do të jetë koordinimi, bashkërendimi dhe monitorimi i projekteve të Organizatave Ndërkombëtare e shoqërisë civile (OJQ-ve), të financuara nga donatorë të ndryshëm që e mbështesin riintegrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë. Përveç kësaj, që të sigurohet se programet e projekteve adresojnë nevojat e riintegrimin dhe janë në harmoni me politikat shtetërore dhe angazhimin institucional, do të vendoset një sistem efektiv i bashkëpunimit dhe koordinimit të projekteve të riintegrimin nga MPB/DRPR. Po ashtu, një pjesë e buxhetit të riintegrimin do të përdoret për financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve të riintegrimin. Ky proces do të rregullohet nga MPB-ja me legjislacionin përkatës.

MPB/DRPR-ja ka parasysh se kërkohen njohuri të veçanta për aspektet e cenueshme me të cilat përballen të kthyerit, si dhe shërbimet e specializuara në të gjitha nivelet, sidomos në nivel komunal që nevojiten për të mbështetur të kthyerit e cenueshëm që nga momenti i kthimit të tyre në Kosovë. Prandaj, një rendësi të veçantë gjatë zbatimit të kësaj strategjie do t'i kushtohet ngritjes së kapaciteteve të stafit të përfshirë në riintegrimin, në të gjitha nivelet, që në mënyrë profesionale, duke identifikuar dhe menaxhuar rreziqet e procesit, t'i adresojnë nevojat e personave të riatdhesuar për riintegrim të qëndrueshëm të tyre.

Fuqizimi i sistemit të riintegrimin dhe ngritja e kapaciteteve në nivel lokal, pas transferit të shërbimeve dhe vendimmarrjes së riintegrimin nga MPB/DRPR në komuna, kërkon një qasje të veçantë përmes avancimit të sistemit tashmë të krijuar, duke përmirësuar në vazhdimësi proceset në bashkëpunim të ngushtë me MAPL dhe organizatat ndërkombëtare e vendore, me efekt në riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar.

5. MEKANIZMAT ZBATUES

Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar është organi më i lartë përgjegjës për menaxhimin e riintegrimin të personave të riatdhesuar, përfshirë hartimin e politikave, legjislacionit, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikave të riintegrimin. DRPR-ja është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve emergjente në momentin e arrijtes. Menaxhon buxhetin për riintegrim dhe bashkëpunon me akter vendor dhe ndërkombëtar me qëllim të avancimit të riintegrimin të qëndrueshëm. Koordinimi, bashkërendimi dhe monitorimi i projekteve të riintegrimin që zbatohen nga organizata ndërkombëtare e vendore, po ashtu është njëra ndër përgjegjësit e DRPR-së në kuadër të menaxhimit të procesit të riintegrimin.

DRPR-ja koordinon procesin e riintegrimin të personave të riatdhesuar me nivelin komunal, përmes koordinatoreve rajonal, të cilët së bashku me zyrtarët komunal për riintegrim bashkërendojnë procesin e informimit dhe ofrimin të shërbimeve. Një nga përgjegjësitë e DRPR-së është të organizojë trajnime të rregullta dhe punëtori rajonale me zyrtarët komunal për riintegrim, për të ngritur kapacitetet e tyre në lidhje me risitë në legjislacion dhe politika, si dhe për t'u njohur me sfidat e procesit të riintegrimin në nivel lokal.

Ministritë e linjës, si: MPMS, MMPH, MSH, MASHT, MAPL, MBPZHR, bazuar në mandatin e tyre¹⁸ kanë përgjegjësi t'i reflektojnë politikat e riintegrimin në kuadër të politikave sektoriale të tyre dhe t'u ofrojnë autoriteteve komunale mbështetje adekuate teknike, e financiare për përfshirje të personave të riatdhesuar në mekanizmat e mbrojtjes sociale dhe ekonomike brenda mandatit të tyre. MeD në fushën e ripranimit dhe riintegrimin, shërben si ndërlidhëse për komunikim e bashkërendim ndërmjet pjesëtarëve të diasporës dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.

Në nivel lokal, përfitimet dhe ndihma në përkrahje të riintegrimin, kryesisht organizohen si pjesë e shërbimeve komunale dhe shërbimeve tjera lokale, në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë ndërmjet autoriteteve lokale të mirëqenies sociale, shëndetësisë, punësimin, arsimit, banimit dhe ofruesit tjerë të shërbimeve, sipas kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

ZKKK¹⁹-të janë pika e parë e kontaktit për personat e riatdhesuar pas kthimit në komunën e origjinës dhe kanë rol qendror në përpjekjet për riintegrimin e kësaj kategorie në shoqëri. Roli i ZKKK-ve në procesin e riintegrimin të personave të riatdhesuar është informues, këshillues, vlerësues dhe monitorues. ZKKK-të kanë përgjegjësi të informojnë, ndihmojnë dhe këshillojnë personat e riatdhesuar për mundësitë dhe kriteret e përfitimit nga skemat e riintegrimin. Zyrtarët i ndihmojnë të riatdhesuarit në plotësimin e kërkesave, pranojnë dhe evidentojnë kërkesat nga personat e riatdhesuar, bashkëpunojnë me koordinorët rajonalë dhe akterët tjerë lokal, referojnë personat e riatdhesuar për shërbimet që ofrohen nga institucionet lokale për të siguruar mbështetje dhe ndihmë të mëtutjeshme dhe mbledhin dhe regjistrojnë informatat në E- Sitemin e Menaxhimit të Rasteve.

Qendra për Punë Sociale luan rol të rëndësishëm gjatë procesit të riintegrimin të personave të riatdhesuar në komunën përkatëse. QPS ,si pjesë e ekipit të vlerësimin të nevojave, bën vlerësimin e përgjithshëm të nevojave të familjeve të riatdhesuara përmes shqyrtimit të informatave nga SMR, dokumentacionit në dispozicion dhe intervistimi të familjeve në terren, me vëmendje të veçantë familjeve me fëmijë dhe personave me nevoja të veçanta. Roli i QPS është i veçantë në rastin e ripranimit dhe riintegrimin të fëmijëve të pashoqëruar.²⁰

¹⁸ Shih shtojca 3- Institucionet përgjegjëse në Zbatim të Strategjisë për Riintegrim të personave të Riatdhesuar.

¹⁹ Roli dhe përgjegjësitë e Zyrate Komunale për Komunitetet dhe Kthim (ZKKK), në procesin e riintegrimin të personave të riatdhesuar janë përcaktuar me Rregulloren Nr. 13/2007 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar

²⁰ Udhëzuesi për ripranimin dhe riintegrimin e fëmijëve të pashoqëruar në shoqërinë kosovare.

Drejtoria Komonale të Arsimit, në bashkëpunim me shkollat kanë rolin kryesor në përfshirjen e fëmijëve të riatdhesuar në sistemin arsimor, duke siguruar kurse të gjuhës dhe mësim plotësues bazuar në nevojat e nxënësve pas kthimit.

Zyrat e Punësimit dhe Qendrat e Aftësisimit Profesional sigurojnë përfshirjen e të riatdhesuarve në MATP, konkretisht në shërbimet e punësimit, vetëpunësimit, aftësisimit profesional, profilizimit dhe këshillimit për zhvillim në karrierë për integrimin e qëndrueshëm ekonomik të personave të riatdhesuar.

Drejtoria Komonale të Bujqësisë do të përkujdesën që një përqindje e përfituesve të mjeteve dhe materialeve bujqësore, të jenë nga personat e riatdhesuar në komunën e tyre, në kuadër të mbështetjes për riintegrim të qëndrueshëm të tyre.

Drejtoria dhe zyrat tjera në nivel lokal, bazuar në mandatin e tyre, do të përkujdesën të ofrojnë ndihmën adekuate të personave të riatdhesuar për riintegrim në komunitet, bazuar në nevojat e tyre.

Komisioni Komunal i Riintegritimit (KKR) vepron në kuadër të komunës përkatëse, mandati i të cilit është të shqyrtojë dhe të vendosë për kërkesat e personave të riatdhesuar për përfitim nga skemat e riintegritimit që financohen nga buxheti i riintegritimit.

Së paku një herë në vit, akterët relevant në nivel lokal duhet të organizojnë takime konsultative me OJQ-të dhe Organizatat Ndërkombëtare që punojnë në fushën e riintegritimit (duke përfshirë organizatat avokuese) si dhe me personat e riatdhesuar dhe përfaqësuesit e tyre për të identifikuar problemet në terren dhe për të definuar mënyrat e përpalljes me sfida në përfshirjen sociale dhe ekonomike të personave të riatdhesuar, e sidomos pjesëtarëve të grupeve të cënueshme.

Komisionin për Ankesa vepron në kuadër të MPB-së, mandati i të cilit është të shqyrtojë dhe të vendosë për ankesat e personave të riatdhesuar kundër vendimeve të Komisioneve Komunale të Riintegritimit.

6. AKTIVITETET DHE NISMAT

Me qëllim të arritjes së objektivave të kësaj Strategjie, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme:

Procesi i riintegrit

- Ofrimi i mbështetjes socio-ekonomike për riintegrim të qëndrueshëm dhe sigurimi i kualitetit të shërbimeve të garantuara sipas rregullave dhe procedurave ligjore;
- Kombinimi i politikave sociale dhe ekonomike në nivelin strategjik me anë të masave të mbështetjes individuale të bazuar në nevoja;
- Zhvillimi dhe realizimi i pakove standarde të shërbimeve për mbështetjen e riintegrit të personave të cenueshëm, të përshtatur për çdo grup;
- Zhvillimi i planeve komunale për riintegrim të qëndrueshëm, që do të jenë gjithëpërfshirëse, të bazuara në nevoja dhe të orientuara kah zhvillimi;
- Përmirësimi i sistemit të identifikimit, gjurmimit, referimit dhe shërbimit të personave të cenueshëm;
- Sigurimi që personat e riatdhesuar janë të informuar siç duhet për të gjitha mundësitë e përfitimeve të ndihmës para dhe pas kthimit;
- Përmirësimi i cilësisë së sistemit të aftësimit profesional: vlerësimi i nevojave, mbajtja e trajnimeve dhe vlerësimi i ndikimit të trajnimeve.
- Harmonizimi i nevojave dhe kërkesave të tregut të punës me fushat e aftësimit profesional për të siguruar punësimin e të riatdhesuarve pas aftësimit profesional;
- Sigurimi i zbatimit të politikave afatgjata të banimit për të riatdhesuarit;
- Shtirja e informimit dhe këshillimit profesional me qëllim të përmirësimit të qasjes në fonde për hapjen e bizneseve të reja me qëllim të krijimit të vendeve të punës;
- Lehtësimi i përfshirjes së riatdhesuarve në prodhimtari bujqësore, përmes mbështetjes me grande bujqësore dhe me material e mjete bujqësore për të kthyerit në zonat rurale;
- Përqendrimi në mbrojtjen e fëmijëve të të kthyerve dhe viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, të kthyerit nga zonat e konfliktit dhe kategorive tjera me nevoja specifike, gjatë gjithë procesit të riintegrit;
- Zhvillimi i sistemeve dhe procedurave standarde për sigurimin e cilësisë së proceseve të riintegrit, menaxhimin e rrezikut dhe integritetit dhe sigurinë e informacionit;

Monitorimi dhe vlerësimi i procesit të riintegrit

- Zhvillimi dhe zbatimi i platformës së monitorimit dhe vlerësimit për të mundësuar monitorimin dhe vlerësimin e plotë të statusit të proceseve të riintegrit, për të mundësuar ndërmarrjen e veprimeve të duhura korrigjuese dhe përmirësimin e mëtejshëm;
- Sigurimi i monitorimit efektiv të zbatimit të planeve lokale të riintegrit;
- Monitorimi efektiv i realizimit të skemave/shërbimeve të mbështetjes për personat e cenueshëm;
- Monitorimi dhe vlerësimi i skemave të riintegrit të qëndrueshëm ekonomik e social dhe vlerësimi në ndikimin e tyre në riintegrim të qëndrueshëm;
- Avancimi, përditësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i Sistemit për Menaxhimin e Rasteve (SMR);

Zhvillimi kapaciteteve të nevojshme të akterëve të përfshirë në riintegrim në të gjitha nivelet

- Fuqizimi i kapaciteteve të të gjithë akterëve, në të gjitha nivelet, për të zhvilluar, zbatuar dhe monitoruar politika efektive të riintegrit dhe për të ofruar shërbime standarde profesionale;

- Zhvillimi i shkathtësive të posaçme që ndërlidhen me identifikimin dhe realizimin e projekteve të riintegrit me anë të trajnimeve të synuara;
- Rritja e kapaciteteve të akterëve të përfshirë për zhvillimin, realizimin dhe monitorimin e skemave/shërbimeve për personat e cenueshëm;
- Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e nevojave, referimin dhe trajtimin e grupeve të cenueshme;
- Fuqizimi i kapaciteteve për bashkërendimin dhe koordinimin e realizimit të planeve lokale të veprimit;

Bashkëpunimi gjithëpërfshirës

- Përmirësimi i sistemit për shkëmbimin e informative me vendet nikoqire dhe organizatat ndërkombëtare për të siguruar informata cilësore dhe me kohë para dhe pas arritjes;
- Fuqizimi i bashkëpunimit me ambasadat e Kosovës në vendet nikoqire dhe ambasadat e vendeve nikoqire në Kosovë në fushat e ofrimit, shkëmbimit dhe verifikimit të informatave lidhur me të kthyerit;
- Bashkëpunimi i ngushtë me vendet nikoqire, si dhe organizatat joqeveritare lokale dhe ndërkombëtare, për të bashkërenduar asistencën financiare dhe teknike, si dhe për të lehtësuar zhvillimin e programeve të riintegrit të strukturuar dhe të financuar;
- Zhvillimi i mekanizmave për bashkërendim të shtuar ndërmjet organeve përkatëse shtetërore dhe akterëve të tjerë sa i përket ofrimit të skemave/shërbimeve për kategoritë e ndryshme të personave të cenueshëm;
- Zbatimi i mekanizmave për rritjen e vëmendjes dhe fondeve sa i përket riintegrit të personave të cenueshëm;
- Zhvillimi dhe ruajtja e partneriteteve efektive me shoqërinë civile, mediat dhe organizatat ndërkombëtare për promovimin e masave për mobilizim të qëndrueshëm shoqëror.
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut lidhur me procesin e riintegrit, politikat, mekanizmat, dhe ndihmën përmes një plani të komunikimit me publikun;

Pasqyra e kufizimeve

Sikurse vetë natyra komplekse e procesit të riintegrit edhe zbatimi i kësaj strategjie, paraqet një proces kompleks të shoqëruar me rreziqe të mundshme. Rreziqet e mundshme të vlerësuara, që mund të kenë ndikim në zbatim të kësaj strategjie, konsiderohen:

Buxheti i pamjaftueshëm kufizon mundësinë e ofrimit të shërbimeve për personat e riatdhesuar, qasjen bazuar në nevoja, sidomos nëse fluksi i të riatdhesuarve vazhdon të rritet. Kufizimet buxhetore gjithashtu e bëjnë të pamundur adresimin e nevojave të veçanta për secilin grup të të riatdhesuarve dhe kategorisë së grupeve të cenueshme;

Niveli i ulët i bashkëpunimit sistematik ndërmjet drejtorive relevante komunale për referimin e rasteve, vlerësimin e nevojave dhe ofrimin e shërbimeve paraqet kufizim në zbatim të kësaj strategjie;

Kapacitetet e pamjaftueshme të stafit për menaxhim dhe monitorim të procesit të riintegrit dhe për trajtim të nevojave të natyrës psiko-sociale të personave të riatdhesuar;

Trajtimi psiko-social i të riatdhesuarve paraqet sfidë, marrë parasysh kapacitetet e limituara në institucionet e specializuara për trajtimin e tyre. Stigmatizimi i kësaj kategorie në shoqëri, e rëndon edhe më tutje gjendjen e tyre. Kapacitetet e pamjaftueshme të institucioneve relevante shëndetësore dhe psiko-sociale vështirëson marrjen e ndihmës adekuate dhe rrintegrimin e qëndrueshëm si proces.

Mundësitë e vogla për të zgjidhur çështjen e banimit të qëndrueshëm, mungesa e banesave sociale dhe qendrave strehuese për kujdes dhe mbrojtje të fëmijëve të pashoqëruar si dhe mungesa e shtëpive për të moshuar pa përkujdesje familjare vështirëson riintegrimin e qëndrueshëm;

Kapacitetet e kufizuara të zyrave të punësimit në komuna për të profilizuar dhe për të këshilluar të kthyerit për zhvillim të karrierës, kombinuar me mundësitë e kufizuara të punësimit për shkak të shkallës së lartë

të papunësisë si dhe gama e vogël e profileve të aftësisë profesionale, kufizon punësimin si masë kyçe në procesin e riintegrit;

Informatat e pamjaftueshme nga shtetet dërguese për profilin e të kthyerve, sidomos në lidhje me gjendjen shëndetësore, dosjen penale si dhe nevojat specifike të të kthyerve, kufizon mundësitë e ofrimit të shërbimeve të parapara me këtë strategji;

Kufizimet e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal për shkëmbim të informatave dhe përvojave si dhe mungesa e koordinimit të asistencës dhe projekteve të donatorëve të ndryshëm mund ta kufizojë zbatimin e kësaj strategjie.

Plani i Veprimit

Për zbatimin e kësaj Strategjie është hartuar Plani i Veprimit. Plani i Veprimit mbulon periudhën tri vjeçare (2018-2020), dhe përmban objektivat strategjike dhe specifike, aktivitetet konkrete për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv dhe saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, përcakton koston e përafërt financiare dhe indikatorët për matjen e objektivave.

7. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Procesi i zbatimit të Strategjisë së Riintegrit do të jetë proces i arritjes së objektivave strategjike, specifike dhe aktiviteteve përkatëse. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të përcjellë zbatimin e Strategjisë së Riintegrit, për të matur nivelin e zbatimit të objektivave të saj, për të përcjellë progresin e ndikimit të shërbimeve dhe masave të riintegrit në jetën e qytetarëve, konkretisht riintegrimin e qëndrueshëm të tyre i cili është edhe vizion i kësaj Strategjie.

Monitorimi dhe vlerësimi do të bazohet në indikatorët e identifikuar në Planin e Veprimit, i cili do të bëhet në mënyrë sistematike, bazuar në *Planin e Monitorimit dhe vlerësimit* me përfshirjen dhe angazhimet me palët e jashtme dhe të brendshme me interes, duke ofruar rekomandime dhe duke ndërmarr masa të menjëhershme përmirësuese dhe intervenime strategjike për t'i adresuar sfidat e identifikuara gjatë monitorimit.

Plani për monitorim dhe vlerësim do të ofrojë të dhëna për treguesit e suksesit, gjendja aktuale, synimet për vitin 2019 dhe 2020, institucionet përgjegjëse për raportim, burimin e verifikimit të informatave, afatet e raportimit, progresi i arritur dhe masat e ndërmarra në proces për arritjen e riintegrit të qëndrueshëm.

Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit: MPB është autoriteti kryesor përgjegjës për bashkërendimin dhe zbatimin e monitorimit dhe vlerësimit, me qëllim të sigurimit të mekanizmit koherent dhe të integruar të raportimit. Palët e tjera të interesit, në nivelin qeveritar dhe lokal, përfshirë organizatat ndërkombëtare e vendore, i vejnë në dispozicion të dhënat dhe informatat e nevojshme, dhe përgatisin raporte të rregullta për progresin e tyre. Raportet e rregullta të monitorimit bëhen përmes formës standarde të raportimit të elaboruar nga MPB/DRPR. Organizatat joqeveritare do të marrin pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë në tryezat e përbashkëta të cilat do të organizohen nga MPB. Kordinator Nacional për riintegrim është përgjegjës të bashkërendojë, udhëzojë, monitorojë dhe të raportoj për zbatimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve në lidhje me strategjinë e riintegrit.

Monitorimi dhe vlerësimi i jashtëm do të behët në vitin e tretë pas aprovimit (2020), dhe vitin e fundit të zbatimit të saj 2022, për të vlerësuar objektivat dhe synimet e arritura me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të politikave të Riintegrit.

Si mjet i monitorimit dhe menaxhimit të rasteve shërben E-Sistemi për Menaxhimin e Rasteve të riintegrit, i cili administrohet nga MPB-ja, në të cilin regjistrohen, ruhen, procedohen dhe arkivohen kërkesat dhe të dhënat e tjera relevante lidhur me personat e riatdhesuar dhe përfitimet e tyre. Përmes SMR-së menaxhohet në tërësi shërbimet dhe përfitimet e personave të riatdhesuar nga momenti i hyrjes në Kosovë deri në mbylljen e rastit, sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Të dhënat e personave të riatdhesuar trajtohen në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Përmes SMR-se, MPB/DRPR synon të:

- Sigurojë një bazë të të dhënave të unifikuar dhe të përbashkët;
- Sigurojë që secili rast individual procedohet në mënyrë të shpejtë, efektive dhe efikase;
- Sigurojë transparencë në menaxhimin e buxhetit të riintegrit;
- Sigurojë bashkërendimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve me interes.
- Standardizojë linjat dhe procedurat e komunikimit vertikal e horizontal;
- Sigurojë bashkërendimin dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtar dhe shoqërinë civile.

Zbatimi i përgjithshëm i Sistemit të Menaxhimit të Rasteve kërkon një përfshirje të përqendruar të të gjitha institucioneve të definuara, në të gjitha aktiviteteve relevante, pasi që është një kombinim i menaxhimit të rasteve dhe sistemit. E-sistemi përfshin jo vetëm nivelin institucional të ofrimit të shërbimeve dhe përfitimeve, por edhe nivelin e punës së drejtpërdrejtë me personat e riatdhesuar.

Zbatimi i E-sistemit do të shtojë efikasitetin dhe efektivitetin e politikave sociale në përgjithësi dhe do të sigurojë që secili rast individual i riintegrit të procedohet në mënyrë efikase dhe efektive. Ai do të sigurojë transparencë të menaxhimit të fondit dhe do të lehtësojë bashkëpunimin në të gjitha nivelet.

Platforma e monitorimit dhe vlerësimit do të zhvillohet dhe do të ofrojë një mbikëqyrje më të gjerë të progresit të procesit të riintegritimit dhe mundëson veprime adekuate përmirësuese dhe avancim të mëtutjeshëm të vlerësimit të zbatimit të politikave të riintegritimit, përfshirë edhe vlerësimin e performances institucionale të akterëve të përfshirë, por edhe vlerësimin e nivelit të riintegritimit të personave të riatdhesuar pas një periudhe 18-24 muaj pas kthimit.

Të gjithë akterët e përfshirë në proces të riintegritimit janë përgjegjës për raportimin e aktiviteteve të zbatuara, në mënyrë që t'i mundësojnë DRPR-së të realizojë vlerësimin dhe ndërmarrjen e masave përmirësuese brenda afateve sa më të shkurtra.

Identifikimi i indikatorëve

Çdo rezultat i planifikuar (aktivitetet dhe ndikimi afatgjatë) i gjeneruar nga veprimet e institucioneve në nivel qendror dhe lokal, si dhe akterëve tjerë të përfshirë në proces të riintegritimit, do të maten duke përdorur indikatorët e identifikuar me Plan të Veprimit.

Menaxhimi i rrezikut

Për menaxhim efektiv të rreziqeve gjatë zbatimit, do të aplikohet një qasje dinamike e menaxhimit të rrezikut. Kjo qasje do të mundësojë fleksibilitet duke nënvizuar mësimet e nxjerra gjatë zbatimit.

Zbatimi dinamik kërkon bashkëpunim efektiv mes partnerëve kyç dhe i kushtohet vëmendje mësimëve të nxjerra në mënyrë që plani i zbatimit të adaptohet në varësi të informatave të reja dhe kushteve të ndryshueshme. Qëndrueshmëria e ndryshimeve në zbatim kërkon edhe kapacitete organizative. Ndërtimi i kapaciteteve të akterëve kyç kërkon angazhim substancial, vlerësim të nevojave deri të definimi i aftësive të dëshiruara dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së këtyre kapaciteteve.

Qasja dinamike proaktive e menaxhimit të rrezikut tashme është adaptuar nga DRPR-ja, duke zhvilluar një Regjistër Rreziku me Planin e Veprimit të Menaxhimit të Rrezikut. DRPR ka mundësi të madhe të ndihmojë akterët relevant në riintegrim që të ndërtojnë proceset e tyre të menaxhimit të rrezikut në mënyrë që të fokusohen në rreziqet strategjike dhe në radhitjen e iniciativave të riintegritimit bazuar në vlerësimin e vazhdueshëm të atyre rreziqeve. Vlerësimi Strategjik i Rrezikut mund të ofrojë bazë të çmueshme dhe hapin e parë për menaxhim të rrezikut dhe qeverisjen që do të sqaronte dhe definonte rrugën për zhvillimin e aftësive të menaxhimit të rreziqeve se si të vlerësohen, monitorohen dhe menaxhohen rreziqet e procesit të riintegritimit. Shembulli i DRPR-së është planifikuar të ndahet me akterët relevant të riintegritimit, në mënyrë që praktika e menaxhimit të rrezikut të përfshihet në tërë procesin e riintegritimit dhe të ndërtohet kultura e mbështetjes.

Komunikimi

Gjatë zbatimit të Strategjisë, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ndarjes efektive të informatave të përditësuara me të kthyerit mbi mundësitë e mbështetjes dhe ndihmës nga masat e riintegritimit, si dhe të ngrihet vetëdija e publikut dhe mobilizimi social përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit.

Shkëmbimi i informatave në nivel ndërkombëtar e rajonal, po ashtu zë një vend të rëndësishëm në zbatimin efektiv të politikave të riintegritimit.

Rezultatet dhe zhvillimet e procesit të riintegritimit do të ndahet me të gjitha grupet e interesit, përmes formave të ndryshme të komunikimit. Komunikimi do të realizohet përmes planit të komunikimit të riintegritimit, i cili do të zhvillohet në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie.

BUXHETI

Qeveria e Republikës së Kosovës siguron buxhetin e nevojshëm për zbatimin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të përcaktuara me këtë Strategji. Buxheti i riintegritimit sigurohet çdo vit me ligjin e buxhetit për vitin përkatës dhe planifikohet në kuadër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH). Po ashtu, Qeveria vlerëson lart kontributin e donatorëve në financimin dhe bashkëfinancimin e aktiviteteve dhe projekteve konkrete për zbatimin e kësaj strategjie.

SHTOJCAT

SHTOJCA A - PËRKUFIZIMET

SHTOJCA B - KORNIZA LIGJORE PËR RIINTEGRIM

SHTOJCA C: INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE NË ZBATIMIN E STRATEGJISË

SHTOJCA A - PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj Strategjie:

Ndihma - nënkupton shërbimet për mbështetjen e personave të riatdhesuar gjatë procesi të riintegritit dhe promovimin e riintegritit;

Përfitimet - nënkuptojnë masat për mbështetjen nga programi i riintegritit;

Sistemi për Menaxhimin e Rasteve (SMR) - është sistem elektronik ku procedohen, ruhen dhe arkivohen informatat për personat e riatdhesuar dhe përfitimet e tyre;

Komisioni për Ankesa- nënkupton organin tek i cili mund të parashtrohet ankesa e parë kundër vendimit të lëshuar nga KQR ose KKR të referuar në këtë rregullore;

Bashkërendimi-nënkupton që ministrinë përkatëse, autoritetet dhe akterët e tjerë e mbështesin riintegrimin në mënyrë efektive bashkë si tërësi;

Menaxhimi i riintegritit në nivelin qendror- nënkupton veprimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Departamentit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR);

Menaxhimi i riintegritit në nivelin lokal - nënkupton veprimet e ndërmarra nga kryetarët e komunave, zyrtarët komunalë për kthim dhe komunitete (ZKKK) dhe koordinatorët rajonalë;

Komisioni Komunal për Riintegrim (KKR)- është organi vendimmarrës i cili përbëhet nga përfaqësuesit e shërbimeve komunale relevante;

Ripranimi –është akti i autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për ripranim të shtetasve të vet dhe shtetasve të vendit të tretë;

Riatdhesimi - është veprimi i kthimit në Kosovë, i realizuar nga një qytetar i Kosovës apo një qytetar me origjinë nga Kosova dhe aplikohet në të gjitha llojet e kthimit në rastin kur hyrja në territorin e Kosovës bëhet përmes një pike zyrtare të kalimit kufitar;

Person i riatdhesuar -nënkupton një kosovar i cili në mungesë të bazës ligjore për qëndrim në vend të huaj është ripranuar në Kosovë;

Persona të riatdhesuar nga Zonat e Konfliktit – nënkupton bashkëshortët dhe fëmijët e pjesëmarrësve kosovarë në luftërat e huaja, të cilët kthehen nga zonat e konfliktit;

Riintegrimi - nënkupton ripërfshirjen e personave të riatdhesuar në shoqërinë e Kosovës dhe promovimin e kushteve të tyre ekonomike, sociale dhe politike në nivelin e qasjes në shërbime, në të drejta dhe mundësi të cilat janë të barabarta me qytetarët e tjerë të Kosovës;

Kthimi- procesi i kthimit prapa të një të huaji, qoftë në pajtim me një obligim vullnetar apo të detyrueshëm për t'u kthyer, në vendin e tij të origjinës apo në vend tjetër;

Kthimi vullnetar –nënkupton pajtueshmërinë me detyrimin për kthim në afatin e caktuar;

Kthimi me forcë- nënkupton ekzekutimin e detyrimit për kthim, përkatësisht transportimin fizik nga shteti kërkues në Republikën e Kosovës.

Personat e cenueshëm -nënkupton personat e riatdhesuar të cilët kanë nevojë për masa të veçanta të riintegritit si pasojë e kapacitetit të tyre të zvogëluar funksional, për shkak të sëmundjes apo aftësive të kufizuara, apo si pasojë e gjendjes së tyre familjare, gjinisë dhe moshës, analfabetizmit apo arsyeve të ngjashme, ose personat të cilëve u mungojnë njohuritë adekuate të gjuhëve zyrtare të Kosovës.

SHTOJCA B - KORNIZA LIGJORE PËR RIINTEGRIM

Legjislacioni përkatës në fuqi në Republikën e Kosovës, që ndërlidhet me procesin e Riintegrit të Personave të Riatdhesuar:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës²¹,
- Ligji nr.04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës²²,
- Ligji nr.04/L-217 për Azil²³,
- Ligji nr.04/L-219 për te Huajt²⁴,
- Ligji nr. 03/L-208 për Ripranim²⁵,
- Ligji nr.04/L-003 për Gjendjen Civile²⁶,
- Ligji nr.02/L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin²⁷,
- Ligji nr.02/L-118 për Emrin Personal²⁸,
- Ligji nr.03/L-172 për Mbrojtjen e te Dhënave Personale²⁹,
- Ligji nr.03/L-099 për Letërnjoftim³⁰,
- Ligji nr.04/L-126 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr 03/L-099 për Letërnjoftim³¹,
- Ligji Nr.03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore³²,
- Ligji nr.03/164 për Financimin e Programeve te Veçanta te Banimit³³,
- Ligji nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme³⁴,
- Ligji nr. 2003/13 mbi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit nr. 2002/5 mbi themelimin e regjistrit të të drejtave në pronën e paluajtshme³⁵,
- Ligji Nr. 04/L-009 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme³⁶,
- Ligji Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës³⁷,
- Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësi³⁸,
- Ligji nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë³⁹,
- Ligji nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale ne Kosove⁴⁰,
- Ligji nr. 03/L-212 i Punës⁴¹,
- Kodi Nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës⁴²,
- Ligji nr. 04/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e kodit penal të republikës së Kosovës nr. 04/L-082⁴³,
- Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale⁴⁴,
- Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti⁴⁵,

²¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

²² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8873>

²³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8869>

²⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>

²⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2687>

²⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2743>

²⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2589>

²⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2570>

²⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2676>.

³⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2593>

³¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2843>

³² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2643>

³³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

³⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2565>

³⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3246>

³⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2748>

³⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13023>

³⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8666>

³⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2460>

⁴⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2826>

⁴¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>

⁴² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>

⁴³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2852>

⁴⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

- Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës⁴⁶,
- Ligji nr. 02/1-17 për shërbime sociale dhe familjare⁴⁷,
- Ligji nr.04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/1-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare⁴⁸,
- Ligji nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor⁴⁹,
- Ligji nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike⁵⁰,
- Ligji nr. 04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën⁵¹
- Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar ne Republikën e Kosovës⁵²,
- Ligji nr.2004/37 për Inspeksionin e Arsimit ne Kosove⁵³,
- Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin ne Komunat e Republikës se Kosovës⁵⁴,
- Ligji nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional⁵⁵,
- Ligji nr.05/L-002 për Ndalimin e bashkimit në Konfliktet të armatosura jashtë territorit të vendit⁵⁶,

Përveç ligjeve të lartpërmendura, ekzistojnë edhe akte nënligjore në fuqi, të cilat janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me procesin e riintegrimin të personave të riatdhesuar në Kosovë.

- Rregullore (QRK) nr. 13/2017 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar⁵⁷,
- Rregullore (MPB) nr. 04/2016 për Funkcionimin e Qendrës së akomodimit për Personat e Riatdhesuar⁵⁸,
- Rregullore (MPB) nr. 04/2015 për Subvencionimin e projekteve që promovojnë Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Republikën e Kosovës⁵⁹,
- Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 24/2015 për Regjistrimin e mëvonshëm në regjistrat e gjendjes civile,
- Te shtohen udhëzimet e MASHT

Strategjitë të cilat kanë ndërlidhje me procesin e Riintegrimin të Personave të Riatdhesuar në Kosovë:

- Strategjia për përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021⁶⁰,
- Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 – 2020⁶¹,
- Strategjia shtetërore për Migrim dhe Plani i Veprimit 2013-2018⁶²,
- Strategjia Kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë 2015-2019⁶³,
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër Terrorizmit⁶⁴,

⁴⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9517>

⁴⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>

⁴⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447>

⁴⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2808>

⁴⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2401>

⁵⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2573>

⁵¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2831>

⁵² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

⁵³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2453>

⁵⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2543>

⁵⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8676>

⁵⁶ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10763>

⁵⁷ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15304>

⁵⁸ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13220>

⁵⁹ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11047>

⁶⁰ <http://kryeministri-ks.net/repository/docs/ALB->

STRATEGJIA_PER_PERFSHIRJEN_E_KOMUNITETEVE_ROM_DHE_ASHKALI_NE_SHOQERINE_KOSOVARE_2017-2021.pdf

⁶¹ <http://kryeministri->

ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_PER_PARANDALIMIN_E_EKSTREMIZMIT_TE_DHUNSHEM_DHE_RADIKALIZIMIT_QE_SHPIE_NE_TERRORIZEM_2015-2020.pdf

⁶² http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Acrobat_Document.pdf

⁶³ http://kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_KOMBETARE_KUNDER_TRAFIKIMIT_ME_NJEREZ_NE_KOSOVE_2015-2019.pdf

⁶⁴ http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_e_Republikes_se_Kosoves_kunder_Terrorizmit.pdf

- Strategjia për komunitete dhe kthim 2014-2018⁶⁵,
- Strategjia sektoriale e shëndetësisë 2017-2021⁶⁶,
- Plani strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021⁶⁷,
- Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018⁶⁸.

Konventat ndërkombëtare që ndërlidhen me procesin e riintegrit, të zbatueshme në Republikën e Kosovës:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa e Gjenevës për mbrojtjen e refugjatëve, 1951, si dhe Protokolli i vitit 1967;
- Konventa e Nju-Jorkut për Personat pa Shtetësi;
- Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave;
- Konventa e OKB-së kundër torturës dhe trajtimeve apo dënimeve të tjera të vrazhda, çnjerëzuese dhe degraduese, 1984;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen dhe Lirive Themelore të Njeriut si dhe protokollet e saj;
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- Konventa Ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike si dhe protokollet e saj.

⁶⁵ http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Komunitete_dhe_Kthim_2014-2018.pdf

⁶⁶ http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia-sektoriale-e-shendetesise-final-nentor-2016-ALB_.pdf

⁶⁷ http://kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI_STRATEGJIK_I_ARSIMIT_NE_KOSOVE.pdf

⁶⁸ http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Diasporen_dhe_plani_i_veprimit_2013-2018.pdf

SHTOJCA C: INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE NË ZBATIM TË STRATEGJISË

Niveli qendror

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) - Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR)

DRPR-ja funksionon brenda MPB-së, është përgjegjëse për hartimin e politikave të riintegrimin në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë tjera të linjës, si dhe është organi përgjegjës për menaxhimin e riintegrimin të personave të riatdhesuar. DRPR është përgjegjës për:

- Hartimin e politikave dhe legjislacionit që ka të bëjë me riintegrimin, si dhe monitorimin e zbatimin e tyre;
- Përgatitja e udhëzimeve mbi procedurat e riintegrimin dhe hartimi e nxjerrja e udhëzimeve për autoritetet lokale;
- Monitorimi i zbatimit të programit të riintegrimin;
- Krijimi i mekanizmave efektivë për mbledhjen, raportimin dhe shpërndarjen e informatave ndërmjet administratës qendrore dhe asaj lokale;
- Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve informuese për komunat dhe personat e riatdhesuar;
- Përgatitja e një plani të përgjithshëm të trajnimit për autoritetet komunale në fushën e riintegrimin;
- Bashkëpunimi dhe bashkërendimi me organizatat vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me riintegrimin e personave të riatdhesuar;
- Mirëmbajtja dhe avancimi i Sistemit të Menaxhimit të Rasteve (SMR) si dhe
- Shqyrtimi i kërkesave në kompetencën e nivelit qendror.

Pranimi i personave të riatdhesuar organizohet përmes zyrtarëve të vendosur në Zyrën Pritëse në Aeroportin e Prishtinës si dhe në gjitha pikëkalimet kufitare, ku ata ofrojnë informata për personat e riatdhesuar mbi mundësitë e përfitimit, identifikojnë nevojat emergjente, si dhe ofrojnë shërbime transportimi në rast nevoje. Bashkërendimi i procesit të riintegrimin ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, si dhe verifikimi i rasteve në terren bëhet përmes koordinatorëve rajonalë në bashkëpunim me komunat përkatëse. Qendra për strehim të përkohshëm menaxhohet nga DRPR-ja, si dhe shërben për strehimin e personave të riatdhesuar deri në shtatë ditë; ajo gjithashtu ofron shërbime themelore, si ushqimi dhe trajtimi mjekësor sipas nevojës.

Kordinatori Nacional për Riintegrim-Kordinatori Nacional është Ministri i Punëve të Brendshme ose personi i autorizuar nga ai, i cili është përgjegjës të bashkërendojë, udhëzojë, monitorojë dhe të raportoj për zbatimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve në lidhje me strategjinë e riintegrimin. **Sekretariati i Strategjive në MPB** ka për detyrë të hartoj raporte periodike dhe vlerësuese për kordinatorin nacional. Përveç këtyre, sekretariati do ta ndihmojë kordinatorin nacional për koordinimin e strategjisë dhe komunikimin me palë të interesit.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) - Misioni i MPMS-së është të përforcojë dhe të krijojë hapësirë për mirëqenie sociale, angazhim në programe trajnimit për punësim dhe aftësim për të gjithë qytetarët në gjendje nevoje sociale. Përgjegjësitë e MPMS-së në fushën e punësimit janë formulimi dhe zbatimi i masave aktive dhe pasive të tregut, si dhe politikat që krijojnë qasje në tregun e punës, lehtësimi i tranzicionit drejt tregut të punës, kontributet në përputhshmëri më të mirë të kërkesës me ofertën, si dhe ndihma në riintegrimin e grupeve të cënueshme.

Qendrat e punësimit dhe aftësimin profesional menaxhohen nga Departamenti i Punës dhe Punësimit, si dhe zbatohen përmes Zyrave të Punësimit dhe Qendrave të Aftësimin Profesional. MPMS-ja është gjithashtu institucioni i nivelit qendror të qeverisjes që merret me të gjitha çështjet e lidhura me politikat sociale dhe

skemat pensionale. Departamenti për Politika Sociale e Familjare, si dhe Departamenti për Pensione janë përgjegjës për çështjet e politikave sociale dhe pensionet. Në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, Qendrat për Punë Sociale kanë rol kryesor, si dhe monitorohen nga Drejtoria për Shëndet dhe Mirëqenie Sociale, si pjesë e përgjegjësive komunale.

Në bazë të programeve që MPMS-ja ka, si dhe obligimeve që rrjedhin nga Rregullorja për riintegrimin e personave të riatdhesuar, MPMS-ja do të ofrojë shërbimet vijuese:

- Përkrahja dhe krijimi i mundësive për qasje në tregun e punës, përmes masave aktive dhe pasive të tregut të punës;
- Ofrimi i trajnimeve për personat e riatdhesuar, me qëllim të përgatitjes së tyre për treg të punës;
- Ofrimi i ndihmës sociale dhe pagesave nga skemat pensionale, për të gjithë ata që plotësojnë kërkesat sipas legjislacionit në fuqi.
- Ofrimi i shërbimeve për fëmijë dhe mbrojtja e tyre sipas formave të mbrojtjes, përmes Qendrave për Punë Sociale dhe angazhimit të OJQ-ve në ofrim të shërbimeve.
- Ofrimi i shërbimeve të strehimit për viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje, përmes Qendrave për Punë Sociale dhe OJQ-të e kontraktuara.
- Ofrimi i shërbimeve për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara dhe me çrregullime të vogla mendore.

MPMS është përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e këtyre shërbimeve në procesin e riintegrit dhe raporton mbi përparimin dhe sfidat në zbatimin e Strategjisë së Riintegrit dhe Planit të Veprimit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përmes Departamentit të Banimit dhe Ndërtimit, harton kornizat ligjore, institucionale e financiare të cilat mundësojnë qasje të barabartë në banim të përshtatshëm për të gjithë qytetarët, në bazë të kapaciteteve të tyre financiare dhe gjendjes së tyre sociale e shëndetësore.

Politikat e banimit ofrojnë kushte të qëndrueshme të banimit për familje apo individë që nuk mund t'i përballojnë ofertat e tregut për banesa, për shkak të gjendjes së tyre ekonomike, si dhe përcaktojnë edhe mënyrat e sigurimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e programeve të veçanta të banimit në komuna. Ofrimi i banimit me qira përmes programeve të vendosura me ligj: banim me qira jofitimprurëse si dhe banimi me bonus qiraje. Kjo do të realizohet përmes banesave të ndërtuara nga komuna, qeveria, banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, që jepet me qira; banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të përshtaten apo shfrytëzohen në pajtim me programet e veçanta të banimit.

Ministria e Shëndetësisë (MSH)- Qëllimi i Ministrisë së Shëndetësisë është të sigurojë bazën juridike për mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës, përmes promovimit të shëndetit, veprimtarisë parandaluese dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe cilësore shëndetësore. Ministria e Shëndetësisë harton politikat dhe zbaton ligjet për një sistem mosdiskriminues dhe llogaridhënës të shëndetësisë.

Kujdesi shëndetësor organizohet dhe zbatohet në tri nivele: primar, sekondar dhe terciar. Komunitat janë përgjegjëse për kujdesin primar dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore në territorin e tyre. Kujdesi primar shëndetësor ofrohet dhe zbatohet në kuadër të mjekësisë familjare, në pajtim me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë. Sipas Ligjit për Shëndetin, personat e riatdhesuar lirohen nga participimi në vitin e parë pas riatdhesimit.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) - MASHT-i ka mandat e përgjegjësi të veçantë për të siguruar kushtet themelore për arsimimin e personave të riatdhesuar. Është obligim i

MASHT-it, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera të angazhuara në ofrim të arsimit parauniversitar që të sigurojë, për të gjithë fëmijët, të drejta të barabarta të shkollimit, në përputhje me nevojat dhe aftësitë e tyre specifike.

Procesi edukativ është me rëndësi të posaçme gjatë procesit të riintegritimit të personave të riatdhesuar. Mes të kthyerve do të ketë një numër të lartë të fëmijëve dhe të rinjve që duhet të vazhdojnë arsimimin e tyre. MASHT-i duhet të jetë e përgatitur të pranojë dhe sistematizojë të gjithë nxënësit e të gjitha komuniteteve në të gjitha nivelet arsimore, në përputhje me legjislacionin shtetëror në fuqi. MASHT-i do të fokusohet posaçërisht tek arsimi i detyrueshëm, ku fillimisht nxënësit do të regjistrohen në shkolla me anë të procedurave joformale. Në këtë drejtim, MASHT-i do të hartojë broshura për riintegrimin e personave të riatdhesuar në lidhje me mundësitë dhe të gjitha shërbimet e disponueshme, për të lehtësuar regjistrimin e nxënësve në institucione shkollore.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) - Ndhmon në hartimin e politikave dhe përkufizimin e objektivave për zbatim të Strategjisë së Riintegritimit dhe ofron informata për komunat në përditësim të materialeve të riintegritimit. MAPL-ja, në bashkëpunim me ministritë tjera të linjës, ndihmon në hartimin e planeve të trajnimit dhe organizon kurse trajnimi në nivel lokal për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

Ministria e Diasporës (MeD)- Në kuadër të fushëveprimit të saj, MeD-ja harton dhe zbaton politika e projekte që kanë të bëjnë me Diasporën. Në fushën e ripranimit dhe riintegritimit, MeD-ja shërben si element ndërlidhës për komunikim e bashkërendim ndërmjet pjesëtarëve të diasporës dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) - Komponenti kryesor i MKK-së është riintegrimi i personave me prejardhje nga Kosova që janë të zhvendosur në territorin e ish-Jugosllavisë dhe brenda Kosovës. Në procesin e riintegritimit të personave të riatdhesuar, Ministria për Komunitete dhe Kthim bashkëpunon me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe ministritë tjera të linjës. Ministria për Komunitete dhe Kthim mban statistika në lidhje me personat e zhvendosur në rajon (Serbi, Mal të Zi, Maqedoni, si dhe Bosnjë e Hercegovinë) apo edhe brenda Kosovës si pasojë e luftës së viteve 1998 – 1999, si dhe personat e zhvendosur brenda Kosovës. MKK-ja mban informata për kornizat institucionale, procedurat e ripranimit dhe riintegritimit, procedurat për ndihmën ndaj personave të zhvendosur, si dhe bashkëpunimin me aktorë të tjerë relevantë.

Ministria e Financave (MF) - MF-ja është institucioni përgjegjës për sigurimin e rritjes së të ardhurave buxhetore, monitorimin e përgjithshëm, si dhe menaxhimin e drejtë dhe transparent financiar të fondeve publike, si dhe ka rol thelbësor në përcaktimin dhe zbatimin e politikave financiare e fiskale të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) - MBPZHR harton dhe zbaton politika agro-rurale me qëllim të sigurimit të mundësive të punësimit dhe krijimit të të ardhurave për qytetarët që jetojnë në zona rurale. MBPZHR-ja jep kontribute të rëndësishme në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm për zhvillim rural e bujqësor, duke mbështetur drejtpërdrejt bujqit, industrinë agro-përpunuese, infrastrukturën e ujitjes dhe grupet rurale lokale. Gjithashtu, personat e riatdhesuar që jetojnë në zona rurale janë përfitues të këtyre politikave mbështetëse. MBPZHR-ja përafron politikat shtetërore me Politikën e Përbashkët Bujqësore të BE-së (ACP), si dhe ka themeluar struktura administrative, si Agjencia për Zhvillim të Bujqësisë, Departamenti për Politika Bujqësore (Autoriteti Menaxhues), Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje, Departamenti për Shërbime Këshillore, Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore, për zbatimin e këtyre politikave.

Niveli lokal

Në nivel lokal, përfitimet dhe ndihma për mbështetje të riintegrit kryesisht organizohen si pjesë e shërbimeve komunale dhe shërbimeve të tjera lokale, në bashkëpunim e koordinim të ngushtë me autoritetet lokale të mirëqenies sociale, shëndetësisë, punësimit, arsimit, banimit dhe ofrues të tjerë shërbimesh. Secila komunë duhet të ketë Zyrën Komunale për Komunitete e Kthim (ZKKK) dhe Komisionin Komunal të Riintegrit (KKR) sipas kompetencave të përcaktuara me Ligjin e Vetëqeverisjes lokale.

Zyra Komunale për Komunitete e Kthim (ZKKK) - Në nivelin lokal, Zyra për Komunitete e Kthim (ZKKK) është trupi kryesor për riintegrim të personave të riatdhesuar. ZKKK-ja, në procesin e riintegrit të personave të riatdhesuar, ka përgjegjësitë vijuese:

- Të informojë, të ndihmojë e të këshillojë personat e riatdhesuar për mundësitë dhe kriteret e përfitimit nga Programi i Riintegrit si dhe për plotësimin e kërkesave;
- Të pranojë dhe të identifikojë kërkesat nga personat e riatdhesuar;
- Të vlerësojë nevojat paraprake dhe të përpunojë kërkesat për MKK-në dhe DRPR-në për vendim-marrje;
- Të zbatojë, bashkë me aktorët tjerë, vendimet e MKK-së dhe KQR-së;
- Të mbështesë dhe të monitorojë gjendjen e personave të riatdhesuar, në koordinim me koordinatorët rajonalë;
- Të bashkëpunojë me koordinatorët rajonalë dhe aktorët tjerë lokalë;
- Të informojë personat e riatdhesuar për shërbimet që ofrohen nga Zyra e Punësimit dhe zyrat tjera komunale, si dhe të orientojë personat drejt zyrave për mbështetje e ndihmë të mëtutjeshme;
- Të mbledhë dhe të shënojë informatat në sistemin elektronik;
- Të raportojë në baza të rregullta tek Kryetari i Komunës dhe Komisioni Komunal në lidhje me rrethanat e komunës në kuptimin e riintegrit.

Komisioni Komunal për Riintegrim (KKR) - Komisioni Komunal për Riintegrim merr vendime për kërkesat e dorëzuara nga personat e riatdhesuar për përfitime emergjente. KKR-ja vlerëson nevojat relevante të personave të riatdhesuar, në lidhje me qasjen në regjistra të gjendjes civile, marrjen e dokumenteve civile, arsimin dhe regjistrimin në shkolla, trajnime psiko-sociale sipas nevojës, si dhe ndihma sociale, në banim dhe nxjerrje të dokumenteve kadastrale.

Drejtoritë Komunale - Drejtoritë komunale në territorin e komunës përkatëse janë përgjegjëse që në kuadër të kompetencave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi të ofrojnë ndihmë e përkrahje për personat e riatdhesuar gjatë procesit të riintegrit.